



ZGJIDHNI SHKOLLËN “UDHA E SHKRONJAVE”

Cambridge International School
organizatore e Olimpiadës Kombëtare

Të parët për certifikimet Cambridge IGCSE, ICE
Të parët në provimet kombëtare të Ministrisë së Arsimit

Agnes Metani

Rekord ndërkombëtar për certifikimet e Kembrixhit 2024-2026
Pranuar në Leysin American School, Zvicër (bursë e plotë)
për të studiuar IB Diploma për vitet 2026-2028



Artur & Mirela Shkurti
Drejtues të shkollës



Isis Mullaj - LAS, Zvicër (2024-26)
Pranuar në Princeton University



Klasa 1, 2 - Zechino d'Oro in Albania
Teatri i Operas dhe Baletit, 2025

Universitetet e toplistës botërore që pranian nxënësit tanë



Princeton, MIT, Duke University - SHBA
University of Toronto, Waterloo, Alberta - KANADA
University of Edinburgh, Leicester, King's - ANGLI
University of Western Australia - AUSTRALI
TUM Müh, Karlsruher KIT, Freiburg - GJERMANI
Groningen, Vrije, Amsterdam, Twente - HOLLANDË
KU Leuven (Katholieke Universiteit) - BELGJIKË
Tor Vergata, Politecnico di Milano, Bologna, Torino - ITALI
Istanbul Technical University - TURQI
Paris I Panthéon-Sorbonne, Paris Dauphine-PSL - FRANCË





Përmbajtja e revistës

Shkollë e performancës së lartë (fq.3)

Katër referenca (fq.4)

- Vlerësime të Cambridge International (5-8)
- Vlerësime të universiteve të toplistës (9)
- Vlerësime të komunitetit të shkollës (11-25)
- Vlerësime të Ministrisë së Arsimit (25)

Referenca nga Cambridge International

Ju i frymëzoni nxënësit (fq.5)
Sara Ceroni - Cambridge International

Ndajmë të njëjtat vlera dhe aspirata (fq.5)
Martin Nuttall - Cambridge International

Me botën në mendje (fq.6)
Paul Bullen-Smith - Cambridge International
Shkollë pilot për Global Perspectives.

Drejt një shkolle të një klasi botëror (fq.7)
Debora Eyre - High Performance Learning

Referenca nga Kembrixhi (fq.8)
Rezultatet, raporte, inspektime

Referenca ndërkombëtare

Pranimet në universitete të toplistës botërore (fq.10)
Një milionë euro bursa të fituara në kolegje (fq.11)

Referenca nga komuniteti i shkollës (fq.12)

Mirëqenia me vlerësim të vetë nxënësve (fq. 13)
Agnes Metani: Drejt Leysin American School (fq. 14)
Sinergjia tipar i shkollës - Artur Shkurti (fq. 16)
Ish-nxënësit na vlerësojnë (fq. 17)
Nga prindër të shkollës (fq. 20)
Poezi për shkollën, Myslim Pashaj (fq.20)
Olimpiada Kombëtare - vlerësime (fq. 21)
Mësuese Benilva Zoga (fq. 22)
Mësuese Elira Curri (fq. 23)
Mësuese Besiana Vathi (fq.24)
Përshtypje nga Abdi Baleta (fq. 25)
Për librat "BESA" dhe "GJUHA SHQIPE".

Fjala e Bujar Leskaj në Kuvendin e Shqipërisë (f26)

Për shpërfilljen e Rilindjes Kombëtare

Referenca nga Ministria e Arsimit (fq.27)

Riti i Identifikimit të Bujarëve Shqiptarë (fq. 28)

PROGRAMET E SHKOLLËS

CIKLI 1 fillor (primary) (5-11 vjeç) (fq.29)
CIKLI 2 Lower Secondary (klasa 6-8) (fq.31)
CIKLI 3 IGCSE (klasa 9-10) (fq.32)
CIKLI 4 As - A Level (Diploma AICE) (fq.33)

Edukimi i karakterit dhe virtyteve (fq.34)

Shkolla Online (certifikuar nga Kembrixhi) (fq.35)
Regjistrimi në shkollën tonë (fq.36)
Olimpiada Kombëtare "Udha e shkronjave" (fq.37)
Botimet "Udha e shkronjave" (fq.40)
Albumi "Zëri i adheut", 10 këngë patriotike (fq.46)
25 maj - përkujtimi i Vëllezërve Frashëri (fq.47)
200-vjetori i Pashko Vasës (fq.49)
Foto përfaqësuese të veprimtarive (fq.50)
Lidhja e Fiseve të Shkodrës (fq.53)



Për informacion dhe regjistrime

Celular: 0692076068
E-mail: info@udhaeshkronjave.edu.al
arturshkurti@gmail.com
Website: www.udhaeshkronjave.com



Nga Artur dhe Mirela Shkurti

Themelues, zotërues dhe drejtues të shkollës
“Udha e shkronjave” (1997)

Shkollë e performancës së lartë

që edukon vetëdijen kombëtare dhe kompetencën globale

“Udha e shkronjave” u themelua në vitin 1997.

Edhe pak dhe festojmë 30 vjet punë mësimore.

Kemi synuar një shkollë që ta nderojë sistemin arsimor shqiptar në cilësinë e lartë mësimore dhe të mirëqënies, në respektimin e lirive dhe të drejtave të fëmijëve, në edukimin e vetëdijes kombëtare dhe globale, dhe në edukimin e karakterit dhe të virtyteve.

Trashëgojmë si shkollë çfarë ka patur më të mirë tradita jonë kombëtare në arsim. U përputhëm me standardet më të larta ndërkombëtare të Kembrixhit. Kemi kombinuar programet kombëtare me ato ndërkombëtare dhe me programet tona origjinale, pra të shkollës sonë.

Kemi organizuar Olimpiadën Kombëtare duke filluar nga viti 2000. Olimpiada “Udha e shkronjave” ka qenë vepërimtaria më e madhe kombëtare në fushën e testimit të njohurive në klasat 0-9, moshë 5-15 vjeç. Kemi përgatitur botimet tona të teksteve mësimore bazë dhe ndihmëse që janë vlerësuar si të një cilësie mjaft të lartë: Abetarja “Udha e shkronjave” 2001 (Artur Shkurti), librat “Eja në test” 1-8 (Artur & Mirela Shkurti). Në 2004 botuam “Logjikën formale” për klasat 7-8-9. Më 2005 fituam konkursin e Ministrisë për “Matematikën 6” (Artur Shkurti & Sitki Spahia), që u zbatua në 100% të shkollave në vitet 2005-2007 dhe më 2006 fituam konkursin për “Dituri natyre 3” (Artur Shkurti & Mirela Shkurti) (97 pikë nga 100) dhe vijuem me të tjerë libra.

Në 2012 iu bashkuam **Komunitetit Global të Shkollave të Kembrixhit**. Në 2016, Kembrixhi na zgjodhi **Shkollë Pilot e Kembrixhit për programin Cambridge Global Perspectives**. U orientuam **drejt pranimeve në universitetet e toplistës botërore (100 më të mirat)** dhe ia kemi arritur masivisht në vitet e fundit (listën e gjeni në këtë broshurë). Jemi shkolla që ka mbërritur mbi 1 milionë euro në bursa që marrin nxënësit e klasës së dhjetë për të ndjekur programe të diplomave ndërkombëtare. Suksesi më i madh i arritur në performancën e një nxënësi ka qenë sivjet me Agnes Metanin, e cila realizoi në vitet 2024-2026 trembëdhjetë certifikime ndërkombëtare dhe me rezultate maksimale.

Misioni i shkollës është t’i përgatisë fëmijët për botën që i rrethon, por edhe t’u japë përgatitjen, dashurinë dhe dëshirën për të jetuar e punuar për vendin e tyre.

Shumë nxënës tanë të ndjekin studimet dhe jetën profesionale jashtë vendit. Kemi shtuar investimin në natyrën kombëtare të shkollës, në argumentimin më të mirë se pse një nxënës duhet të jetojë e punojë në



Shqipëri, me shpresën se do të frenohet emigrimi dhe do të nxitet kthimi i atyre që po jetojnë jashtë. Kjo nuk është vetëm sfidë e jona, sfidë kombëtare, por edhe globale. Argumenti ynë është diçka, por “argumenti” i jetës konkrete në Shqipëri është diçka tjetër. Shpopullimi është pasojë e dobësisë shqiptare, por dobësia e shqiptarëve reflekton sulmin e gjithanshëm në të cilin ata ndodhen, që do të thotë se edhe shpopullimi është pjesë e sulmit që u bëhet shqiptarëve.

Një nga arritjet e veçanta të shkollës është **programi i edukimit të karakterit dhe të virtyteve**. Ky program synon formimin e virtyteve intelektuale, morale, qytetare dhe të performancës, si edhe ushtrimin e urtësisë.

Mund të themi me siguri se nxënësit tanë dëshmojnë me sukses vetëdije kombëtare dhe kompetencë globale.

Krahas shkëlqimit akademik, ne ofrojmë gëzimin e jetës së përditshme. Nxënësit e konfirmojnë këtë mirëqenie në pyetësorët e Kembrixhit: **mirëqenie të kompetencës, të marrëdhënieve ndërpersonale, kënaqësi për jetën dhe mungesë emocionesh negative.**

Për nxënësit e rinj që zgjedhin “Udha e shkronjave” ne ofrojmë **kursin e përshtatjes me shkollën.**

Kemi numrin më të madh të referencave

Referencat kanë shumë rëndësi për prindin. Referencat tona janë edhe institucionale, edhe individuale, edhe të marra në mënyrë profesionale dhe të besueshme. Prindi do të bindet plotësisht.

“Udha e shkronjave” ka referenca ndërkombëtare nga Cambridge International, nga kolegje dhe universitete të toplistës, nga komuniteti i shkollës (prindër, nxënës, mësues), nga Ministria e Arsimit. “Udha e shkronjave” është e vetmja shkollë që ofron këtë nivel informimi dhe cilësie në referencat që sjell.

Ju ftojme të lexoni këtë revistë, por edhe të bisedoni me ne si drejtues për më shumë detaje rreth regjistrimit të fëmijëve në shkollën tonë.

Nëse prindi zgjedh shkollën “Udha e shkronjave” mendojmë se ai bën zgjedhjen më të mirë. Argumentet do t’i gjeni të detajuara në këtë revistë.

Katër referenca të rëndësishme për shkollën

- Ministria Kombëtare e Arsimit
- Ministri Ndërkombëtare (Cambridge)
- Komuniteti i shkollës “Udha e shkronjave”
- Komuniteti i shkollave dhe universiteteve



Rendësia e referencave të ministrive

Në faqet që vijnë do të japim më shumë detaje lidhur me secilën nga referencat (dy ministri dhe një komunitet).

Ministritë japin lejet për shkollat private dhe ato kontrollojnë përputhshmërinë me pritshmëritë e tyre në çështje të cilësisë mësimore apo të mirëqënies dhe të sigurisë etj.. Kjo do të thotë që raportet e tyre për cilësinë dhe performancën e shkollës kanë një rëndësi të veçantë për prindin.

Lejet e funksionimit të shkollës

Nga Ministria e Arsimit (9-vjeçare)

“Udha e shkronjave” është shkollë private e arsimit bazë e licensuar nga Ministria e Arsimit me urdhër nr.7 datë 30 maj 1997, për arsimin bazë. Cikli fillor fillon me klasën parashkollore dhe përfundon në klasën e pestë. Cikli i mesëm i ulët fillon në klasën e gjashtë dhe përfundon në klasën e nëntë me provimet shtetërore të liritimit, dhe me dhënien e Dëftesës së Liritimit.



Nga Qendra Kombëtare e Licensimit (e mesme)

“Udha e shkronjave” është edhe shkollë e mesme.

Leja si shkollë e mesme LN-9938-08-2015, është dhënë datë 6 gusht 2025, nga Qendra Kombëtare e Licensimit. Deri tani kemi punuar vetëm me klasën e dhjetë (viti i parë). Më pas nxënësit tanë aplikojnë në kolegje të tjera ndërkombëtare, ose kombëtare.



Nga Kembrixhi (Cambridge International School)

“Udha e shkronjave” mban statusin Cambridge International School (Shkollë ndërkombëtare e Kembrixhit) me miratim më 25 korrik 2012 nga Cambridge International Education, që është departament i Universitetit të Kembrixhit.

Në 2022 morëm edhe miratimin si Shkollë Online të Kembrixhit.

Paketat mësimore ndjekin katër cikle: Primary, Lower Secondary, IGCSE dhe A Level.



Komuniteti i shkollës “Udha e shkronjave”

Formohet dhe drejtohet nga drejtoria e shkollës “Udha e shkronjave” dhe përbëhet nga drejtuesit (Artur & Mirela Shkurti), mësuesit, prindërit, nxënësit që janë aktualisht apo që kanë qenë më parë në shkollën “Udha e shkronjave”.

Komuniteti i shkollave, kolegjeve dhe universiteteve

Vlerësim i rëndësishëm është vlerësimi i shkollave, kolegjeve ndërkombëtare apo universiteteve që pranojnë nxënësit tanë. Cilësia provohet me sasinë e bursave që marrin, apo me pranimet në toplistën botërore.



Ju i frymëzoni nxënësit

U kënaqa shumë që vizitova shkollën “Udha e shkronjave” gjatë udhëtimit tim të fundit në Tiranë dhe që ju takova personalisht ju, Artur, dhe ekipin tuaj të përkushtuar.

Me shumë vite bashkëpunimi të suksesshëm me *Cambridge International Education*, ju keni treguar vazhdimisht një përkushtim të thellë ndaj cilësisë më të lartë në mësimdhënie dhe ndaj standardeve ndërkombëtare.

Kjo reflektohet jo vetëm në rezultatet mbresëlënëse të nxënësve tuaj në provimet e Kembrixhit, por edhe në mënyrën se si ata mbështeten dhe inkurajohen çdo ditë.

Përtej anës akademike, ju ofroni një arsimim vërtet të gjithanshëm, me shumë mundësi në shkenca, gjuhë, arte, sport dhe teknologji. Më bëri veçanërisht përshtypje të dëgjoj histori për nxënësit tuaj që sot studiojnë në universitetet më të mira të botës.

Ju i frymëzoni nxënësit të mendojnë në mënyrë të pavarur, të rriten në vetëbesim dhe të zhvillohen si individë të ekuilibruar.

Ju uroj juve, nxënësve dhe stafit tuaj shumë suksese në sezonin e ardhshëm të provimeve, por edhe shumë vite të tjera plot arritje!



Sara Ceroni

Manager for
Southeast Europe,
Cambridge International

04 shkurt 2026



“Udha e shkronjave” iu bashkua Komunitetit Global të Shkollave të Kembrixhit, në vitin 2012. Kemi numrin më të madh të certifikimeve IGCSE dhe të dëftesave Cambridge ICE në Shqipëri, me më shumë lëndë mësimore dhe me rezultatet më të larta në Shqipëri. Rezultatet tona janë ndjeshëm më të larta sesa mesatarja globale e shkollave të Kembrixhit në botë.

Ndajmë të njëjtat vlera dhe aspirata

Është kënaqësi të jem sërish këtu në shkollën tuaj. Kanë kaluar shumë vite tashmë që jeni Shkollë Ndërkombëtare e Kembrixhit.

Ne e vlerësojmë marrëdhënien tonë me ju dhe me kolegët tuaj. Mendoj se ndajmë të njëjtat vlera dhe aspirata për të krijuar një arsimim të gjithanshëm për nxënësit tanë, për t'i përgatitur ata për botën përtej shkollës.

Dëshiroja t'ju përgëzoja, në veçanti, për këto rezultate të shkëlqyera që keni arritur gjatë viteve të fundit, por sidomos këtë vit, kur patët rezultate vërtet të shkëlqyera me nxënësit e klasës së nëntë, duke marrë nota maksimale në certifikimet IGCSE dhe në Diplomën ICE.

Pra, përgëzime për nxënësit tuaj, përgëzime për ju dhe për mësuesit tuaj. Ne presim me kënaqësi të vazhdojmë një marrëdhënie shumë të mirë dhe tashmë të konsoliduar me shkollën tuaj.

Ju urojmë gjithë të mirat për të ardhmen dhe pres me padurim t'ju vizitoj sërish herën tjetër dhe të shoh rezultate edhe më të mira nga edhe më shumë nxënës tuaj.



Martin Nuttall

Head of Partnerships
& Project, Europe,
Cambridge
International Education

28 gusht 2025



“Udha e shkronjave” në shkollat e para në botë që pilotoi programin Cambridge Global Perspectives

Programi mëson aftësitë e nivelit të lartë: kërkim, analizë, vlerësim, reflektim, komunikim, bashkëpunim dhe kompetencë globale.

Në foto: Artur Shkurti dhe Mirela Shkurti në Kembrixh, Konferenca e 25 shkollave pilot të Kembrixhit (prill 2016), mbajtur në Jesus College.

Pilotimi u krye në vitet 2016-2018. Pas pilotimit (2018), programi po vijon të mësohet, në mijëra shkolla të Kembrixhit në 160 shtete të botës.



Me botën në mendje

Ju faleminderit për mundësinë për të shkruar disa fjalë për revistën “Me botën në mendje” (Udha e shkronjave), e lidhur me Olimpiadën Kombëtare dhe që i kushtohet Kompetencës Globale, programit tonë Cambridge Global Perspectives dhe Objektivave Globalë të Kombeve të Bashkuara.

Rëndësia e vetëdijes globale dhe e ndërlidhjes globale është duke u rritur ditë pas dite, por kuptimi prapa “të qenët global” jo.

Nisma si e juaja janë një pjesë e rëndësishme për rritjen e të kuptuarit global dhe një mundësi për nxënësit e rinj për të parë rëndësinë dhe vendin e tyre në botë. Programe si tonat, inisiativa si tuajat dhe fokusi në objektiva të matshme dhe prioritetet të organizmave botërorë si OKB, të gjitha shpien para në një mënyrë sistematike rëndësinë e reflektimit të mendimit kritik dhe bashkëpunimit në botën e sotme, gurë themeli të edukimit global.

Faleminderit për mundësinë që më dhatë dhe fat të mbarë me Olimpiadën Kombëtare.

Paul Bullen- Smith

Drejtuues i Kembrixhit për lëndën Cambridge Global Perspectives
6 nëntor 2015, mesazh urimi për revistën “Me botën në mendje” (Udha e shkronjave)




Bullen-Smith dhe Shkurti
Konferenca e Shkollave
Pilot të Kembrixhit për
Global Perspectives 2016

Drejt tipareve të një shkolle të klasit botëror



Debora Eyre, Artur Shkurti
Konferenca e shkollave të Kembrixhit

Konferenca e Shkollave të Kembrixhit, në Homerton College, Cambridge, UK. Prof. Eyre dha leksionin "Të mësuarit e performancës së lartë", ide nga libri i saj "High Performance Learning" (2016). Libri propozon arsyetimin për transformimin e shkollës në një shkollë të klasit botëror.



"Udha e shkronjave" është e vetmja shkollë shqiptare që është më afër objektivit për të qenë shkollë e klasit botëror. Ajo ka përqindjen më të lartë të pranimet në kolegje e universitete të toplistës botërore. Në këtë revistë do të gjeni emrat e nxënësve të pranuar në toplistën e universiteteve të 10 shteteve: SHBA, Kanada, Angli, Australi, Gjermani, Itali, Francë, Belgjikë, Hollandë, Turqi. "Udha e shkronjave" del e pakonkurrueshme si shkollë, pas klasës së dhjetë, ku ajo nxit dhe ndihmon nxënësit të aplikojnë në kolegjet me më reputacion në Evropë, që ofrojnë Diplomë Ndërkombëtare. Sasia e bursave që marrin nxënësit tanë pas klasës së dhjetë e ka kaluar vlerën 1 milionë euro. Nxënësit tanë dëshmojnë aftësi në ndërmarrjen e nismave dhe përfundimin e projekteve me rëndësi për komunitetin. Janë shumë profesionalë në atë që bëjnë. Shumë prej tyre, punojnë në kompani lider në botë, ose në institucione ku profesionalizmi kërkohet shumë i lartë.

Rubrika e identifikimit të shkollës së klasit botëror (Debora Eyre, High Performance Learning, 2016, fq.100)

1. Eyre: "Mësuesit, nxënësit dhe prindërit mund të përshkruajnë llojin e nxënësit që formon shkolla dhe të shpjegojnë pse kjo është e rëndësishme."

Broshura jonë për këtë tipar jep dëshmi kuptimplota nga mësuesit, prindërit dhe nxënësit "Udha e shkronjave".

2. Eyre: "Mësuesit e shohin kurrikulën e zgjedhur si mbështetëse të vizionit të përgjithshëm. Ajo plotësohet qëllimisht për të ofruar një gamë të gjerë dhe të balancuar mundësish që do të zhvillojnë ACP-të dhe VAA-të. Ekzistojnë mundësi të shumta pasuruese, të përshtatshme dhe të planifikuara mirë." (ACP, Advanced Cognitive Performance; VAA - Values, Attitudes and Attributes).

"Udha e shkronjave" u caktua nga Kembrixhi në grupin e shkollave të para në botë për pilotim dyvjeçar (2016-2018) të programit Global Perspectives, ku mësohen aftësitë e nivelit të lartë. Për VAA shih Programin e Edukimit të Karakterit dhe të Virtyteve "Udha e shkronjave".

3. Eyre: "Nxënësit janë nxënës aktivë, të sigurt në vete dhe gjithnjë e më autonomë. Shkollimi bëhet "me" nxënësit, jo "mbi" nxënësit. Prindërit janë aktivë në mbështetjen e të nxënësve të fëmijës së tyre dhe punojnë në harmoni me shkollën." Broshura sjell prova prej vetë nxënësve tanë që referojnë se i kanë këto tipare (aktivë, të sigurt, të pavarur) ndihen qartësisht të përfshirë në planin e shkollës dhe shkolla në planin arsimor edukativ të familjes. Kolegjet dhe universitetet e toplistës verifikojnë praninë e këtyre tipareve në proceset e pranimeve dhe fakti që nxënësit tanë studiojnë aty, e provon këtë tipar që thekson Eyre.

4. Eyre: "Mësuesit dhe ekipi drejtues kanë aspirata të larta dhe presin që të gjithë nxënësit të kenë sukses. Ata e përcjellin këtë besim te nxënësit. Ekziston një fokus i qartë në heqjen e pengesave ndaj arritjeve." Broshura jonë e paraqet mjaft mirë këtë. Ajo dëshmon pritshmëritë dhe realizimet tona të larta për nxënësit.

5. Eyre: "Të gjithë janë të vetëdijshëm se mirëqenia mendore dhe arritjet akademike janë të ndërlidhura, dhe shkolla ofron mbështetje të fortë si në përgjithësi ashtu edhe për individët. Nxënësit e ndiejnë këtë mbështetje."

Mirëqenia e nxënësve "Udha e shkronjave" matet nga Kembrixhi me standard profesional ndërkombëtar. Rezultatet tona janë jashtëzakonisht të larta në mirëqenie.

"Udha e shkronjave" edhe pse ka patur rezulta të larta dëshmon se rezultatet e saj vijnë në ngjitje, duke thyer rekorde në cilësi e mirëqenie. Kjo tregon sa ajo po e përdor traditën për një cilësi gjithmonë e më të mirë.

Treguesit e koherencës së brendshme janë në nivele shumë të larta. Mësuesit dëshmojnë nivele të larta të kënaqësisë nga puna, kolektivi, nxënësi dhe mungesa e stresit dhe zhvillimi profesional.

Respektimi i vetë sektorit të arsimit për shkollën tonë është më i larti. Tregues janë pranimet me bursa të larta të nxënësve tanë. Leysin American School në Zvicër ka pranuar tre nxënës nga "Udha e shkronjave". UWC Albania jep disa bursa ndërkombëtare. Janë katër nxënës tanë që e kanë fituar këtë bursë. Grupi QSI ka pranuar katër nxënës tanë me bursën më të lartë. Pranimet në universitete të toplistës botërore janë provë e padiskutueshme.

Kjo qartësisht është një nivel i lartë i vlerësimit të cilësisë së shkollës "Udha e shkronjave" nga vetë sektori të arsimit.



Verësim i lartë nga Kembrixhi

“Udha e shkronjave” (1997) iu bashkua komunitetit global të shkollave të Kembrixhit në vitin 2012. *Cambridge International Education*, është departament i Universitetit të Kembrixhit dhe lider botëror në ofrimin e programeve dhe kualifikimeve mësimore për moshat 3-19 vjeç. Mbi 10 000 institucione arsimore në 160 shtete bashkëpunojnë me Kembrixhin. Në 2025, mbi 650 000 studentë nga 5000 shkolla morën kualifikimet IGCSE & A Level.

Raportet e Kembrixhit provojnë shkëlqimin tonë

Edhe rezultatet e vitit 2026, në IGCSE, AS Level, Checkpoint, apo në Progression Test, provuan një shkëlqim ndërkombëtar. Cambridge International jep raporte, certifikime, dëftesa që përfshijnë të gjithë jetën e shkollës, deri edhe tek integriteti i provimeve që zhvillojmë. Raportet e Kembrixhit dalin nga provimet, dhe kualifikimet (certifikimet), inspektimet, përshtypjet. Rezultatet tona botohen “Udha e shkronjave” me referencë të verifikueshme nga Kembrixhi:

Rezultatet në IGCSE tregojnë cilësinë tonë në klasat nëntë dhe dhjetë. Rezultatet në ICE, tregojnë dëftesën ndërkombëtare (me 7-9 lëndë IGCSE). *Certifikimet As & A Level tregojnë cilësinë tonë në klasat 11-12.*

Kembrixhi jep raporte botërore për rezultatet në certifikimet IGCSE, dhe A Level dhe po ashtu për provimet Progression Tests dhe Checkpoint. Në këtë mënyrë, prindi ka mundësi të krahasojë rezultatet e shkollës “Udha e shkronjave” me shkollat ndërkombëtare të Kembrixhit.

Raportet e Kembrixhit tregojnë se “Udha e shkronjave” është:

- 20-40% më lart se mesatarja globale e shkollave
- Mbi 82% e nxënësve kanë “Distinction” në Cambridge ICE.

Rezultatet dalin nga *Primary & Lower Secondary Checkpoint*, klasa 5,8

Nga kontrollet Progression Tests (klasat 2,3,4,5,6,7,8)

Raportet Cambridge School Self-Evaluation Reports (2019, 2022) dhe Cambridge Wellbeing Check (2024, 2025).

Integriteti i provimeve tek “Udha e shkronjave” konfirmohet nga inspektimet periodike të Kembrixhit. Kemi marrë vlerësimin Satisfactory.

Kemi disa botime në blogun e Kembrixhit dhe po ashtu nxënësit tanë promovohen nga Kembrixhi. Në revistë keni përshtypje të shkruara nga drejtues të Kembrixhit Sara Ceroni (2026), Martin Nuttall (2025), dhe Paul Bullen-Smith (2016). Pranimet e shumta në Universitete të toplistës botërore dhe në kolegje që japin Diploma Ndërkombëtare (IB ose AICE) janë një dëshmi e cilësisë së lartë mësimore në kualifikimet e Kembrixhit. “Udha e shkronjave” merr pjesë kaq shpesh në kualifikimet profesionale që organizon Cambridge International Education dhe ata e kanë shtyrë shkollën shumë përpara.



Vlerësime të larta nga Cambridge International Education





Kembrixhi lëshon certifikimet lëndore IGCSE dhe dëftesën ICE, në përfundim të provimeve ndërkombëtare që bëjnë nxënësit. Rezultatet që marrim nga Kembrixhi, shërbejnë si referenca zyrtare ndërkombëtare të Kembrixhit për cilësinë e lartë të shkollës “Udha e shkronjave” që është ndjeshëm më lart se mesatarja globale.

Rekord i klasës së nëntë 2025: Një vit para afatit, klasa e nëntë merr dëftesën ndërkombëtare **Cambridge ICE** me 7 lëndë që parashikohet në klasën e dhjetë, duke u certifikuar me provime ndërkombëtare nga Cambridge. Ky rekord u pasua me rekordin tjetër nga Agnes Metani që mori dy dëftesa ICE me vlerësim “Distinction” (2025, 2026)



Cambridge IGCSE

Cambridge ICE

 Agnes Metani Distinction, 2025	 Abigail Bilbili Distinction, 2025	 Alkuna Shkoza Merit, 2025	 Noem Shkoza Distinction, 2024	 Klara Qirjazi Distinction, 2024	 Leart Çollaku Distinction, 2024	 Aba Gega Distinction, 2024
 Ohrid Qeva Distinction, 2023	 Ilaria Remanica Distinction, 2023	 Klaudio Ajdini Distinction, 2023	 Bora Ballaj Merit, 2023	 Anja Spahiu Merit, 2023	 Pegi Mara Distinction, 2022	 Blerti Zotaj Distinction, 2022
 Martin Fecani Distinction, 2022	 Joan Haxhiu Distinction, 2022	 Arlind Tandili Distinction, 2022	 Kristofor Kamami Merit, 2021	 Jora Demaj Distinction, 2020	 Toni Zemani Distinction, 2020	 Henri Feto Distinction, 2020

“Udha e shkronjave” ka numrin më të madh të lëndëve **Cambridge IGCSE** të certifikuara në periudhën 2013-2026, duke u dhënë nxënësve mundësinë të zgjedhin kurrikulën sipas kushteve: anglisht, italisht, gjermanisht, letërsi botërore, matematikë, biologji, kimi, fizikë, Global Perspectives, Art-Dizajn, Edukim Fizik, Shkencë Kompjuteri, TIK, Kontabilitet, Ndërmarrje, Dramë, Turizëm e udhëtime. Kemi dhënë **22 dëftesa Cambridge ICE**, (17 me vlerësim maksimal “Distinction” dhe 5 “Merit”). 80% e tyre u pranuan në Universitete të top-listës botërore (shih listën në këtë revistë).

Cambridge
Secondary 1

Provimet CAMBRIDGE CHECKPOINT 2024-2026 tregojnë shkëlqimin tonë ndërkombëtar.

Provimet Checkpoint realizohen në fund të klasës së tetë, në lëndët matematikë, anglisht, shkencë dhe Global Perspectives.

91% është rezultati për tre sezonet e fundit, 2024, 2025, 2026.

Kjo mesatare është ndjeshëm më lartë se pragu më i ulët ku merret vlerësimi “Shkëlqyeshëm” (mbi 80%).

87% e vlerësimeve të nxënësve është Outstanding (Shkëlqyeshëm).

9% e vlerësimeve është High 4% e vlerësimeve është Good

Në Global Perspectives 70% e rezultateve janë Silver dhe 30% Gold!

Pranime të shumta në Universitete të Toplistës të nxënësve “Udha e shkronjave”



SHBA

Sibora Seranaj (Duke University)
 Livio Fetahu (MIT)
 Darli Seranaj (Duke University)
 Pegi Mara (Duke University)
 Isis Mullaj (Princeton University)



KANADA

Nensi Shkurti (University of Toronto)
 Elen Mullaj (University of Waterloo)
 Kristofor Kamami (University of Toronto)
 Ohrid Qeva (University of Alberta)



UNIVERSITY OF
TORONTO



UNIVERSITY OF
WATERLOO



UNIVERSITY
OF ALBERTA

ANGLI

Rudin Ferra (University of Edinburg)
 Marin Shkullaku (University of Leicester)
 Henri Feto (King's College London)



THE UNIVERSITY
of EDINBURGH



UNIVERSITY OF
LEICESTER



AUSTRALI

Aidin Kastrati (University of Western Australia)



THE UNIVERSITY OF
WESTERN
AUSTRALIA



GJERMANI

Arbër Cami (Technische Universität München)
 Joli Dallamango (Karlsruher Institut für Technologie)
 Enid Vyshka (Universität Freiburg)



ITALI

Olta Mersini (Tor Vergata, Roma)
 Jorgen Kaftalli (Politecnico di Milano)
 Arlind Tandili (Università di Bologna)
 Martin Fecani (Politecnico di Torino)



TOR VERGATA
UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI ROMA



Politecnico
di Torino



ALMA MATER STUDIORUM
UNIVERSITÀ DI BOLOGNA



POLITECNICO
MILANO 1863

HOLLANDË

Bekli Shtrepi (University of Groningen)
 Eneid Meta (Vrije University)
 Joan Haxhiu (University of Twente)



university of
 groningen



BELGIKË

Elvis Mamani (KU Leuven)
 Jora Demaj (KU Leuven)
 Blerti Zotaj (KU Leuven)



VRIJE
UNIVERSITEIT
AMSTERDAM



TURQI

Earta Joca (Universiteti Teknik i Stambollit)

FRANCË

Emi Memaj (Paris, Douphine PSL)
 Juliana Riska (Paris I: Pantheon Sorbonne)
 Sara Haxhi (Paris II Pantheon Assas)
 Sibora Kashari (Paris I: Pantheon Sorbonne)



Mbi një milionë euro bursa të fituara

nga nxënësit e shkëlqyer të shkollës “Udha e shkronjave”
nga kolegje ndërkombëtare me reputacion të lartë ndërkombëtar

Rikthimi financiar për shkak të shkëlqimit është një nga sukseset më të mëdha të shkollës në ndihmë të familjeve që kanë investuar tek ne. Konkurrenca për bursa në kolegjet ndërkombëtare është globale. Vetëm në një kolegji të Zvicrës aplikantët për bursa mbërrijnë në 400 persona për 3 bursa. Me shkëlqimin e tyre, nxënësit tanë lehtësojnë ngarkesën financiare të familjes. Shkollat e Zvicrës Aiglon dhe Leysin janë nga më të mirat dhe më të shtrenjtat në botë. Bursat dyvjeçare që kanë fituar nxënësit shkojnë nga 280 000 franga siç janë kolegjet e Zvicrës deri në 35 000 euro në QSI.



Darli
Seranaj




Isis
Mullaj



Agnes
Metani



Joan
Haxhiu



Pegi
Mara



Sibora
Seranaj



Noem
Shkoza



Arlind
Tandili



Blerti
Zotaj



Ohrid
Qeva



Aba
Gega



TIRANA INTERNATIONAL
School



TIRANA INTERNATIONAL
School



TIRANA INTERNATIONAL
School



Referenca e vetë komunitetit “Udha e shkronjave”


nxënës - prindër - mësues

Referenca vendimtare është referenca që jepet nga komuniteti i vetë shkollës, pra nga vetë nxënësit, prindërit dhe mësuesit. Që kjo referencë të ketë vlerë, ky vlerësim i tyre duhet të mbledhet periodikisht dhe në mënyrë të standartizuar ndërkombëtarisht, të jetë një proces i hapur dhe me verifikim të vetë komunitetit. Në këtë artikull do të gjeni jo vetëm vlerësimin e komunitetit por edhe shënime se si merret ky mendim, si prodhohet ai në raport.

VLERËSIME TEPËR TË LARTA NGA KOMUNITETI NË RAPORTET NDËRKOMBËTARE CAMBRIDGE SCHOOL SELF-EVALUATION REPORTS

Nga vlerësimi 4.48 në 2019, në vlerësim 5.24 në 2022

Raportet e vetëvlerësimit të shkollës nga komuniteti, që kanë besueshmërinë më të madhe në botë konceptohen nga Cambridge International Education. “Udha e shkronjave” e ka zhvilluar dy herë këtë proces dhe ka marrë dy Raporte Ndërkombëtare të cilat janë pasqyruar në faqen e shkollës “Udha e shkronjave”. Ndërkohë kemi kryer Wellbeing Check në vitet 2024, 2025, 2026.



Raporti 1 doli në nëntor 2019

(qëlloi para tërmetit të nëntorit dhe para pandemisë Covid 2020 dhe për këtë arsye pati një rëndësi të veçantë për ta krahasuar me raportin më pas),

Raporti 2, doli në korrik 2022

(fill pas pandemisë dyvjeçare Covid19. Ky raport tregoi performancën tepër të lartë të jashtëzakonshme të shkollës gjatë pandemisë 2020-2021-2022).

Si mbledhen të dhënat?

Cambridge International (autor i standardeve dhe i procesit) dërgon linket e pyetësorëve të gjatë e të dedikuar (70 pyetje) për **nxënësit, prindërit, mësuesit** dhe vetë **drejtuesit**. Të gjithë e plotësojnë në privatësi dhe të dhënat nuk shkojnë drejtpërdrejtë tek Cambridge, (jo tek shkolla) dhe është Kembrixhi që i përpunon dhe nxjerr raportin.

Për çfarë pyetet komuniteti?

Pyetjet synojnë të kapin vlerësimin e komunitetit për për **vizionin, vlerat, menaxhimin, cilësinë mësimore, pajisjet për mësim, përfshirjen e komunitetit**.

Çfarë tregojnë raportet 2019 dhe 2022?

Vlerësimi është nga 1 (minimal) në 6 (maksimal).

Në 2019 (nëntor), ne morëm një vlerësim agregat (për të gjithë zërat) **në 4.46, afërsisht 75%**.

Ky ishte një vlerësim i lartë. Qëlloi që vlerësim u mor para pandemisë Covid19.

Në 2022 (korrik), pasi kishim kaluar dy vjet pandemi dhe shkollat u fundosën në cilësi, “Udha e shkronjave” tregoi një performancë të shkëlqyer. Vlerësimi u rrit ndjeshëm krahasuar me 2019, duke kaluar **në 5.24, pra 87% të vlerësimit**.

Prindërit, nxënësit, mësuesit vlerësuan jashtëzakonisht mbrojtjen njëkohësisht të shëndetit dhe të cilësisë së lartë mësimore. Krahasuar me statistikën zyrtare patëm 3 herë më pak infeksion në staf, dhe rreth 30% më pak infeksion në komunitet. Patëm 5 muaj mësim online më shumë se të gjitha shkollat dhe mësimi ishte korrekt, masiv, me video, duke mësuar çdo ditë 6 orë të plota (45 min) çdo ditë online me video. Ndërkohë që shkollat e Kembrixhit, në mungesë të testimeve zyrtare (qershor 2020), masivisht dërguan vlerësime 20% më të larta (referencë e Kembrixhit), “Udha e shkronjave” priti sezonin e vlerësimeve zyrtare (tetor 2020) dhe mori rezultate tepër të larta dhe zyrtare (me integritet).

Referenca e vetë komunitetit “Udha e shkronjave”

Mirëqënia e nxënësve tek “Udha e shkronjave” për 3 vjet rresht merr mbështetje 86%

Vlerësimi i mirëqënies nga vetë nxënësit Raportet Cambridge Wellbeing Check 2024, 2025, 2026

“Udha e shkronjave” ofron monitorimin e mirëqënies përmes pyetësorve dhe analizës së Cambridge International (Wellbeing Check). Vlerësohet mirëqënia e kompetencës, mirëqënia e marrdhënieve ndërpersonale, kënaqësia (përm-bushja) për jetën, mungesa e emocioneve negative. Rezultatet tona janë të qëndrueshme, dhe diferencat ndërmjet moshave dhe klasave janë të vogla. Në tre vjet (2024-2026) rezultati final ka qenë 86%.



MIRËQËNIA e kompetencës

Sa shpesh ndihet nxënësi se po e bën diçka mirë.

Nxënësit shprehen se janë “të shëndetshëm”, po realizohen mirë, ndihen të sigurt, dhe mund t’ia dalin me problemet që u dalin para.



Rezultati i lartë provon që cilësia mësimore dhe ndihma ndaj nxënësit “Udha e shkronjave” është e nivelit të lartë, e tillë që e prodhon kënaqësinë. Nxënësi ndihet mirë përditë, dhe detyrat e mësimet nuk i sjellin shqetësime, megjithëse kërkesat janë të larta. Nxënësi i kupton shpjegimet dhe është i aftë. Ka besim në forcat e tij.

Kënaqësia për jetën

Sa shpesh ndihet i kënaqur, optimist për të ardhmen

Nxënësit nuk ndihen të mërzitur, kanë plot energji, i gëzojnë ditët e shkollës, dhe kanë optimizëm për të ardhmen. Në shkollë, nxënësit nuk ndihen të mër-zitur dhe kanë energji pozitive.

MIRËQËNIA e marrdhënieve ndërpersonale

Sa shpesh ndihet nxënësi i lidhur me të tjerët, ndjen që tjerët kujdesen për të, e trajtojnë mirë dhe e vlerësojnë. Për tre vjet rresht (2024, 2025, 2026) kjo ka qenë edhe “mirëqënia” më e vlerësuar. Tashmë është rreth 90%. Tepër lartë. Nxënësi ndihet i lumtur, kupton që shoqëria, stafi mësimor e ndihmës janë miqësorë, dhe nxënësi ndjen që nuk kalon pa u vënë re prej tyre, dhe pothuajse gjithmonë ndihet i vlerësuar; i sigurt, gjithmonë ndihen se trajtohet drejt, nuk ndihet i vetmuar dhe ndjen që njerëzit që e rrethojnë kujdesen për të.



Mungesa e emocioneve negative

Sa shpesh ndjen shqetësim, stres dhe/ose trishtim personal. Nxënësi nuk shqetësohet, nuk ka bullizëm, ose ai është në nivele shumë të ulta. Askush nuk ndihet “i mjerë”, i trishtuar apo i stresuar. Niveli i kënaqësisë për mungesën e emocioneve negative kap mbi 82% të mbështetjes në shkollë, nga vetë deklaratimet e nxënësve.

Nga “Udha e shkronjave” drejt Leysin American School Zvicër

Disa rrugëtimeve nuk ua kupton menjëherë gjurmën që lënë te ti. Ajo zbulohet qartësisht vetëm në çastin që sheh dritaret e shumta të çelura drejt së ardhmes, dhe se ëndrrat, dikur të paarrtshme në dukje, janë kthyer në një realitet mëse të prekshëm. Një rrugëtim i tillë është ai imi në shkollën “Udha e shkronjave”: i nisur në klasën e gjashtë dhe që po i afrohet një përmbylljeje këtë vit, në klasën e dhjetë. Por kjo “mbyllje” do të pasohet shpejt nga një kapitull i ri dhe emocionues për mua, pasi do të mund të vazhdoj dy vitet e ardhshme të gjimnazit në një shkollë ndërkombëtare në Zvicër. E them me bindjen më të madhe se kjo arritje është pasqyrim i përkushtimit dhe vizionit të shkollës “Udha e shkronjave”, ndaj jam thellësisht mirënjohëse dhe falënderuese kundrejt saj.

Duke qenë se nga shtatori i këtij viti e deri më tani në mars, jam përballur me një proces intensiv aplikimesh në 5 shkolla cilësore ndërkombëtare, kam arritur të kuptoj mjaft mirë tiparet, aftësitë dhe virtytet që komitetet e bursave kërkojnë tek një nxënës. Do të doja të veçoja disa prej këtyre tipareve, aftësive e virtyteve, të cilat janë çelësi i pranimeve të suksesshme në shkolla ndërkombëtare, dhe që mendoj se formohen në mënyrë të përsosur në karakterin e një nxënësi të shkollës “Udha e shkronjave”.

Së pari, një kriter thelbësor do të ishin arritjet e larta akademike, jo vetëm në programin kombëtar shqiptar, por në një program mësimor ndërkombëtar. “Udha e Shkronjave” ka 13 vjet që punon me programet ndërkombëtare të Cambridge International Education, duke nisur që nga klasat e fillores. Megjithatë, më e rëndësishme se vetë ofrimi i një kurrikule të tillë është cilësia me të cilën ajo zhvillohet. Ndaj, vlera e vërtetë tek “Udha e shkronjave” qëndron në seriozitetin dhe përkushtimin e lartë me të cilin çdo anëtar i stafit mësimor zhvillon lëndët e programit të Cambridge. Kjo bën të mundur që të gjithë nxënësit të arrijnë rezultate tepër të larta, veçanërisht ata në klasën e nëntë dhe të dhjetë. Tek çdo nxënës ndërtohet një etikë shumë e fortë pune, që i përgatit ata me së miri për t’u ballafaquar me studimet e mëtejshme.

Por “Udha e shkronjave” nuk ndalet me kaq.

Stafi drejtues kujdeset në mënyrë të ndërgjegjshme për të përzgjedhur nxënës me nivele të përafërta mësimore, gjë që krijon një përparësi tjetër. Në rrethana të caktuara, drejtoria merr vendime për të përshpejtuar programet mësimore, duke vendosur një ritëm që tejkalon dukshëm jo vetëm atë të shkollave në Shqipëri, por edhe të institucioneve arsimore nëpër botë. Ky ishte dhe rasti i klasës sime, një grup prej 4 vajzash me dëshirë e vullnet për të mësuar.



Agnes Metani

Klasa 10, “Udha e shkronjave”, 2026
Leysin American School, Zvicër (2026-2028)

REKORD NË CERTIFIKIME NDËRKOMBËTARE IGCSE, ICE

Deri në klasën 10, në dy vjet mori:
12 certifikime IGCSE, nga të cilat 11 me A* dhe 1 me A, dy dëftesa ICE (2025, 2026), dhe një certifikim As Level në matematikë.

SUKSES UNIK NË BURSA TË FITUARA

Pranuar me bursë të plotë (100%) nga katër kolegje me reputacion të lartë ndërkombëtar që ofrojnë Diplomën IB:

Leysin American School, Zvicër (LAS)
Rugby School, Angli
St. Clare’s Oxford
UWC Adriatica, Duino, Itali.
Zgjedhi Leysin American School, Zvicër.



Certifikimet IGCSE: Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi, Shkencë Kompjuteri, Anglisht, Gjermanisht, Italisht, Global Perspectives, Art-Dizajn, Letërsi Botërore, Edukim Fizik.
Certifikimi As Level: Matematikë (Pure 1, 2)
Dëftesa Cambridge ICE: Distinction.

Drejtoria na sfidoi të përfundonim programin IGCSE një vit përpara standardit ndërkombëtar, pra të jepnim provimet për 6 lëndë brenda një viti, në fund të klasës së nëntë, dhe jo në përfundim të klasës së dhjetë siç realizohet në shkollat e Cambridge në botë. Kjo ishte një sfidë që klasa jonë e realizoi në mënyrë shumë të suksesshme dhe që mua më ka dhënë një përparësi të jashtëzakonshme mbi kandidatët e tjerë gjatë procesit të aplikimeve. Një iniciativë e këtij lloji tregon qartazi se “Udha e shkronjave” ka cilësinë akademike të shkollave me reputacion ndërkombëtar.

Pavarësisht kësaj, dua të theksoj se një formim i shkëlqyer akademik nuk është i mjaftueshëm më vete për t’u pranuar në një shkollë cilësore ndërkombëtare. Nxënësi duhet të ketë një profil vërtet të gjithanshëm, dhe “Udha e shkronjave” i kushton rëndësi maksimale që nxënësit e vet të jenë të frymëzuar në shumë drejtime, më tepër se sa thjesht në matematikë apo në shkenca. Si dëshmi personale, vjen fakti që me propozimin e shkollës, unë vjet kam bërë lëndën IGCSE Physical Education, një risi për shkollat në Shqipëri, dhe sivjet po zhvilloj lëndët IGCSE Art & Design si dhe IGCSE World Literature. Kjo vërteton qartësisht shumëllojshmërinë e lëndëve që “Udha e shkronjave” ofron. Unike është mënyra se si këto lëndë trajtohen me po të njëjtën përparësi, seriozitet e përkushtim sa edhe shkencat, madje duke e testuar si pjesë e kurrikulës së Cambridge.

Diçka që harrohet, por që për komitetet e bursave është një faktor parësor, është përshtatshmëria. Një pyetje që ata i drejtojnë vetes dhe kandidatëve gjatë aplikimit, është: “Sa i aftë është nxënësi përballë nesh të përshtatet në mënyrë efektive me mjedisin shoqëror që shkolla jonë ofron?” Kështu, duhet menduar për tiparet e mjedisit të një shkolle ndërkombëtare, dhe ai më dalluesi është pikërisht ndërkombëtarizmi. Përfytyroni një mjedis të pasur me mbi 50 kombësi e kultura të ndryshme nga çdo qoshe e botës. Një “kandidat ideal” nuk duhet të jetë i izoluar brenda kontekstit kombëtar, por të ketë një frymë ndërkombëtare. Fakti që komuniteti i nxënësve tek “Udha e shkronjave” është homogjen nga pikëpamja kulturore mund të shihet si diçka penalizuese për përshtatjen e mëvonshme me një komunitet ndërkombëtar, por jam e bindur se kjo nuk është e vërtetë. Arsyeja qëndron në zhvillimin e lëndës IGCSE Global Perspectives, ku nxënësit mësojnë si të ndërveprojnë me çështje globale dhe si të ndërmarrin veprime konkrete për zgjidhjen e tyre në nivel lokal. Ndaj, një nxënësi që zhvillon lëndën e IGCSE Global Perspectives ka aftësinë dhe gatishmërinë për të qenë një “qytetar global”, pikërisht ajo që një shkollë ndërkombëtare kërkon.

Për më tepër, lënda IGCSE Global Perspectives zhvillon shumë aftësi të çmuara tek një nxënësi, si mendimi kritik. Ato që unë do të doja të veçoja janë bashkëpunimi, reflektimi dhe virtyti i angazhimit qytetar; tre cilësi tepër të rëndësishme për të cilat shkollat ndërkombëtare “hulumtojnë” në grupet masive të kandidatëve.

Megjithatë, nuk është edhe aq e thjeshtë që të provosh se ti vërtet i zotëron këto cilësi, pasi nuk do të ishte bindëse thjesht të thuash: “jam bashkëpunues” apo “jam reflektues”. Duke qenë se Global Perspectives kërkon zhvillimin e një projekti në grup për zgjidhjen e një problemi lokal si dhe reflektimin e shkruar nga çdo nxënësi për punën e përbashkët, një nxënësi që vlerësohet me një rezultat të mirë në këtë lëndë, dëshmon se është i aftë të bashkëpunojë, të reflektojë dhe të veprojë në mënyrë aktive për të përmirësuar komunitetin ku ai jeton. Janë vetëm aftësi të tilla, të dëshmuara shumë mirë, që mund të dallojnë një kandidat të caktuar nga 400 të tjerë.

Së fundmi, formimi kombëtar i një nxënësi është shumë i rëndësishëm, sepse komitetet e bursave kërkojnë që dikush të mund të jetë një përfaqësues i denjë i kulturës së tij në atë mozaik kulturor. Tek “Udha e shkronjave”, ky formim kombëtar është një pjesë e pandashme e edukimit, që ndërtohet tek nxënësit në mënyrë sistematike gjatë gjithë vitit mësimor, dhe jo në mënyrë sipërfaqësore vetëm për ditë të shënuara si për 28 dhe 29 nëntor. Nxënësit e shkollës “Udha e shkronjave” janë të lidhur fort me gjuhën dhe kulturën shqipe, si nga komuniteti shqiptar i mësuesve e shokëve të tyre, si nga veprimtaritë e shumta që organizohen. Një shembull i afërt do të ishte pjesëmarrja e sivjetshme e nxënësve të shkollës sonë në eventin më të rëndësishëm kulturor të Shqipërisë për vitin 2025: 200-vjetori i Lindjes së Pashko Vases, i organizuar nga familja Vasa dhe shkollat “Udha e shkronjave”.

Dua të përmend edhe se stafi drejtues i mësimor është jashtëzakonisht mbështetës në iniciativat e nxënësve, gjë që unë e kam provuar vetë me udhëzimin e pakursyer që më është dhënë gjatë procesit të aplikimeve. Suksesi i pranimit në shkollë cilësore ndërkombëtare varet drejtpërdrejt nga cilësia e mjedisit pararendës arsimor. Tiparet, aftësitë dhe virtytet që “Udha e shkronjave” ndërton tek nxënësit e vet përputhen në mënyrë të përkryer me kërkesat e shkollave elitare ndërkombëtare. Kështu, “Udha e shkronjave” është një institucion që formon nxënësi të gatshëm për të arritur dhe për t’u shquar në sfidat me konkurrencë globale.

Suksesi i Agnesit, dëshmi e sinergjisë

"Udha e shkronjave", nxënës/familje, komunitet

Me **sinergji** kuptojmë bashkëpunimin, ku suksesi është më i madh se shuma e kontributit të pjesëve të marra veçmas. Sinergjia është cilësia më e lartë e komunitetit të shkollës "Udha e shkronjave". Duhet më shumë faqe për ta shpjeguar se si ndikon sinergjia në praktikë për të garantuar suksesin e secilit, por këtu do të themi se suksesi i Agnesit është produkt i kësaj sinergjie që siguron shkolla "Udha e shkronjave".

E falenderojmë Agnes Metanin për vlerësimin e dhënë për shkollën "Udha e shkronjave", për besimin e palëkundur që ka treguar tek ne, për frymëzimin e nxënësve, mësuesve dhe familjeve, dhe të vetë sistemit arsimor shqiptar. Kemi besim që ajo do të bëhet një mjeke e zonja dhe humane njëkohësisht. Katër kolegje e grupe ndërkombëtare nga më të rëndësishmet në Evropë ofruan bursë të plotë 100% për të. Nuk është vetëm shkëlqimi i saj në mësim (edhe pse me rekord në certifikime), por janë karakteri, virtytet e larta të saj që janë hetuar dhe konfirmuar prej tyre në mënyra tepër profesionale, ku përfshihen edhe dëshmitë, intervistat apo referencat tona si shkollë. Jemi të lumtur për besimin e palëkundur që Agnes dhe familja e saj ka patur tek ne. Lexuesi duhet të dijë që Agnes vendosi të qëndronte e vetmja nxënëse e shkollës në klasën e dhjetë për vitin 2025-'26. Nuk u tundua të ndërronte shkollën me shoqërinë!

Jemi të lumtur që ky besim iu shpërblye me suksesin më të lartë që mund të ëndërrojë një nxënës shqiptar apo ndërkombëtar qoftë!

Pablo Pikaso këshillon "Frymëzimi vjen duke punuar".

Ne nuk e ndalim punën, as nxënësit dhe presim që puna të na shpërblejë me frymëzimin e krijimtarisë dhe kjo ka ndodhur saktësisht në shkollë. Nxënësit tanë e kuptojnë këtë. Edhe ata janë të frymëzuar. Agnes ka qenë përherë e frymëzuar dhe kjo na bën të lumtur.

"Udha e shkronjave" rezulton e vetmja shkollë që, pas klasës së dhjetë, i ndihmon nxënësit në aplikimet për diplomën ndërkombëtare. Suksesi ynë me bursat është i jashtëzakonshëm. Vlera e përgjithshme e bursave vitet e fundit po kapërcen një milionë euro. Kjo nuk është "tregëti", por është realitet tepër i lartë. Shkollat që ofrojnë bursat kanë një nivel aq të lartë sa nuk e shkojnë në mend të japin bursa "tregtare". Bursat e tyre janë të vërteta dhe një përfitim i jashtëzakonshëm për nxënësin që e fiton. Nxënësit tanë i justifikojnë këto bursa me pranimet që sigurojnë më pas në universitete të toplistës botërore.

Mjaft të përmendim kolegjet dhe organizatat ndërkombëtare që kanë ofruar bursa për nxënësit tanë:

Leysin American School (Zvicër), Aiglon College (Zvicër), UWC, St Clare's (Oxford), HMCP, Rugby School, YES (SHBA), Duino Itali, QSI etj.



Artur & Mirela Shkurti

Drejtues të shkollës "Udha e shkronjave"

Referenca "Udha e shkronjave" besueshmëri e lartë

Për nxënësit e shkollës "Udha e shkronjave" ne ofrojmë referencë, të bazuar në dëshmitë që kemi nga përvoja e gjatë me nxënësit në anën mësimore, të karakterit dhe virtyteve.

Nxënësit i përgatitim shumë kohë më parë për sfidat e aplikimeve të tyre ndërkombëtare, pra nuk bëjmë "referencën" por bëjmë "realitetin" e referencës. Duam të nderohemi me nxënësit dhe të nderohemi me shkollat që i pranojnë.

Nëse shkollat ndërkombëtare kërkojnë nxënës të suksesshëm, punëtorë, me virtyte, realiteti i nxënësit duhet të jetë vërtetë i tillë.

Referenca japim ne si drejtori, japin mësuesit tanë, dhe nëse munden edhe ish-nxënësit tanë, të cilët ndihmojnë me performancën e tyre.

Në rastin e Leysin American School, Zvicër, sivjet, ish-nxënësja jonë Isis Mullaj është pranuar në Princeton University, duke qenë në krye të LAS. Jemi të bindur që performanca e lartë dhe mbështetja e saj janë një nga faktorët mbështetës të suksesit në aplikimin e Agnesit.



Referenca e vetë komunitetit

Nxënësit vlerësojnë mirëqënien

E kam përfunduar shkollën “Udha e shkronjave” pothuajse 20 vjet më parë dhe, me siguri, mund të them se është një nga shkollat më të mira në Tiranë. Profesionalizmi i tyre, respekti i tyre për jetën dhe dashuria për librat që u jepet të gjithë fëmijëve, vështirë se gjendet sot.



ARBËR CAMI

Arkitekt i softuerit
Mercedes-Benz (Gjermani)
Diplomë Inxhinieri elektrik
dhe shkencë kompjuteri,
nga Universiteti Teknik
të Mynihut (TUM)

OLTA MERSINI

Mjeke neurologe, Austri



Jam krenar që kam qenë pjesë e juaja

Stafi akademik, mënyra e mësimdhënies, olimpiadat kombëtare, veprimtaritë e organizuara dhe shoqërimi i çdo lënde me laboratorë kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë diferencën e shkollës “Udha e shkronjave” me çdo institucion tjetër arsimor, por për mua personalisht ndryshimi dhe diferenca e vërtetë ka qenë në kurrikulën e lëndëve që janë ofruar të cilat i kanë dhënë çdo studenti të kësaj shkolle një shtysë për më tutje dhe një përparësi ndaj studentëve të tjerë.

Nga përvoja ime e studimeve në Gjermani (TUM) dhe aftësia për të bërë krahasime, besoj që **“Udha e shkronjave” është i vetmi institucion arsimor në Shqipëri i cili dhe pas shumë vitesh ndjek ecurinë e studentëve.**

Ky lloj angazhimi është i një institucioni të kalibrit botëror.

Jam krenar që kam qenë pjesë e juaja.

Shumë e kënaqur si nxënëse me “Udha e shkronjave”

Kam qenë nxënëse e shkollës “Udha e shkronjave” prej klasës së gjashtë deri në klasën e nëntë. Mund të them me shumë bindje, se jam gjendur në këtë shkollë **në momentin e duhur**, pasi vitet e përmendura më lart **janë themelore për zhvillimin akademik e personal**. Ajo që e dallon këtë shkollë nga shkollat e tjera është fakti që **nxënësi stimulohet në të gjitha drejtimet**, jo vetëm në profilin shkencor. Çdo lëndë shikohet dhe zhvillohet **me të njëjtin seriozitet**, gjë që u tregon nxënësve, se sa i rëndësishëm është një formim i mirë i përgjithshëm. Në kundërshtim me statistikën e zhvilluara në Shqipëri, që tregojnë qartas, se mësuesit favorizojnë nxënësit e mirë, duke lënë pas ata me arritje më të “dobëta”, në shkollën “Udha e shkronjave” mësuesit janë të përkushtuar, që të gjithë **nxënësit të aktivizohen në lloj dhe të ndihen të vlerësuar në lloj**, gjë që për mua është shumë pozitive, pasi çdo njeri ka nevojë për atë lloj mbështetjeje.

Shkolla **“Udha e shkronjave” i kundërshton të gjitha paragjykimet** që njerëzit kanë zhvilluar me kalimin e viteve **ndaj shkollave private**. Stafi është tejet i përkushtuar, si nga ana akademike, ashtu edhe nga ana sociale. Mbi të gjitha, **gjithsecili trajtohet në mënyrë të barabartë dhe puna e mirë shpërblehet**. Personalisht, kam qenë shumë e kënaqur, pasi kjo shkollë na ka mësuar se si të mësojmë, se sa e rëndësishme është disiplina dhe puna e fortë, gjë që e mbaj edhe sot e kësaj dite me vete.



GENTA HOXHA

“Udha e shkronjave” formon një karakter me virtyte

Kam qenë nxënëse në shkollën “Udha e shkronjave” për 10 vjet.

Kam përfunduar me sukses programin IGCSE atje.

Shkolla më ka përgatitur vërtet për studimet e mia të ardhshme.

Mësuesit janë shumë të kualifikuar dhe të ndihmojnë jo vetëm me punën akademike, por edhe për të krijuar një karakter me virtyte.

Do ta këshilloja për të zgjedhur shkollën “Udha e shkronjave” për të gjithë që dëshirojnë që fëmijët e tyre të kenë një bazë të shkëlqyer arsimimi.



JORA DEMAJ

Studente Administrim Biznesi
në KU Leuven (Belgjikë)



ARLIND TANDILI

Student i mjekësisë
Universiteti i Bolonjës (Itali)

Vitet më të bukura të jetës sime shkollore

Duhet thënë që përballja me programet e përparuara ndërkombëtare ishte një malore e fortë.

Mësuesit e trajtojnë lëndën e tyre me pasion dhe përkushtim maksimal. Shkolla na ka hapur shumë dritare.

Zgjedh ta shkruaj pikërisht tani këtë vlerësim, pasi vlerën e vërtetë të diçkaje e kupton kur nuk e ke më dhe sinqerisht them që e gjithë shkolla do të më mungojë gjithnjë pasi është e pamundur të gesh një kolektiv kaq të përkryer dhe unik sa i kësaj shkolle.

Vitet që kalova aty kanë qenë më të bukurat e jetës sime akademike.

Mirënjohje për shkollën “Udha e shkronjave”

U njoha si fillim me shkollën “Udha e shkronjave” nëpërmjet pjesëmarrjes në Olimpiadën Kombëtare. Niveli i saj i lartë më frymëzoi për të punuar më tej. Vendosa që klasën e tetë ta nisja në këtë shkollë.

Përfundova programet ndërkombëtare të Kembrixhit (Secondary 1 dhe IGCSE).

Ishte i dukshëm progresi akademik vit pas viti me këto programe.

Gjithçka ishte për t'u admiruar: tekstet mësimore, lëndët e veçanta, përkushtimi e përkrahja e mësuesve, atmosfera motivuese, klasat me pak nxënës ku çdokush ndihej i vlerësuar.

Çmoj shumë mbështetjen nga drejtorja, e cila ka qenë gjithnjë e gatshme

për të biseduar, për të mbështetur iniciativat tona e për të na udhëzuar.

I jam shumë mirënjohëse shkollës “Udha e shkronjave” për këto tre vite të mrekulueshme që kam kaluar dhe prej saj ndihem më se gati për të përballuar sfidat që më presin në të ardhmen.

U rekomandoj këtë shkollë të gjithë nxënësve që duan një jetë akademike sfiduese e tepër të frytshme dhe njëkohësisht të krijojnë miqësi të forta e të qëndrueshme.



PEGI MARA

Studente e inxhinierisë
Duke University (SHBA)

Krenare që quhem nxënëse e kësaj shkolle

Kam studiuar tek “Udha e shkronjave” vetëm për tre vjet (klasa 7-9). Mund të mos duket shumë kohë për të fituar një përvojë të vërtetë nga një shkollë, por mund të them se këto 3 vite ishin më të suksesshmet.

Çdo lëndë ishte e rëndësishme, madje edhe Edukata Fizike ose Muzika, të cilat disa mund të mendojnë se nuk janë të rëndësishme në formimin e një fëmije. Të qenët pjesë e klasës me një numër të vogël nxënësish, u dha mundësinë mësuesve të ishin më të kujdesshëm në adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat secili prej nesh përballej gjatë studimit.

“Udha e shkronjave” u jep mundësinë nxënësve të mësojnë se si të punojnë së bashku, të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe gjithashtu të stërvisin të menduarit kritik. Përvoja që fiton, bëhet një trampolinë për shkollën e mesme dhe madje edhe universitetin. Një gjë tjetër e rëndësishme për t’u përmendur janë aktivitetet që shkolla organizon, si ekskursione ose festime, të cilat e bëjnë nxënësin të ndihet më i qetë dhe jo aq i mbytur vetëm me studimin. Mund të vazhdoj pafundësisht të lëvdoj “Udhën e shkronjave”, jo vetëm për profesionalizmin e tyre në mësimdhënie, por edhe për krijimin e një atmosfere të ngrohtë ku një nxënës mund të ndihet si në shtëpi jo vetëm për të studiuar. Së fundmi, jam mjaft i lumtur që shkolla ka zgjeruar kurrikulën e saj me programe ndërkombëtare (programe të Kembrixhit) duke ofruar më shumë mundësi për nxënësit e saj. Jam krenare që quhem ish-nxënëse e kësaj shkolle.

Një përvojë e shkëlqyer të jesh nxënës i shkollës “Udha e shkronjave” Kam nderin të tregoj se si ëndrrat në këtë shkollë marrin udhën e drejtë dhe bëhen të prekshme e të vërteta.

KRISTOFOR KAMAMI

Student i financës
Universitetin e Torontos (Kanada)



FLAVIA TEGO

Shkenca Kompjuterike,
Kaiserslautern, Gjermani



Jam i lumtur që kam qenë pjesë e kësaj shkolle!

Kam studiuar në këtë shkollë për tre vjet, në klasat 7-9. Mendoj se pikërisht këto vite kanë qenë më thelbësoret në formimin tim pasi kam marrë dije të qëndrueshme të cilat më kanë ndihmuar në gjimnaz dhe në universitet njëkohësisht. Gjithashtu jam edukuar me frymën e punës dhe mënyrën e duhur të të menduarit, dy elemente vërtetë kyçe. Kujtoj që çdo orë mësimi zhvillohej me seriozitet dhe përkujdesje maksimale nga stafi. Kemi kryer testime të vazhdueshme për çdo kapitull libri në të gjitha lëndët dhe sistemi i vlerësimit ishte shumë strikt. Përveç pjesës së mësimdhënies, sistemit të provimeve dhe të vlerësimit dhe programit mësimor i cili është tejte i denjë, në shkollë nuk mungonin as veprimtaritë si: kurset e pianos, violines, ping-pong, organizime festive në shkollë, ekskursione etj. Arritje e jashtëzakonshme është edhe Olimpiada Kombëtare që organizon shkolla. Gëzoj shumë kur shoh që “Udha e shkronjave” ka futur programe studimi ndërkombëtare të Kembrixhit. Investimi që një prind bën tek kjo shkollë shkon plotësisht për dije të forta e të qëndrueshme dhe jo për pishina në shkollë, fasada të bukura godinash, klasa ‘luksoze’ etj. Edhe pse pas shumë viteve, ende vazhdoj të ftohem në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të Olimpiadës Kombëtare. Jam i lumtur që kam qenë pjesë e kësaj shkolle!

ERGI KAME

Inxhinier mekatronik & programues

Jam shumë e lumtur që im bir kaloi aty nëntë vite

Kushtuar "Udhës së shkronjave"

Në themel, edhe mbi krye,
vjen një shkollë prej një agimi,
Fjalë e fjalës si fillesë,
Shkon aty, ku vjen Naimi.
Unë ç'të bëj s'kam tjetër udhë
Sepse rroj në musht të shkronjës,
Ndaj po ngjitem që të zbres,
Në atë gjen të vet buronjës.

Myslim Pashaj, 2010

Staf profesionist dhe i përkushtuar,
me programet më të mira. Organizon
veprimtari të shumta me vlera edu-
kative dhe përgatitore për jetën. Vlerësoj
veçanërisht informimin e prindërve.
*E rekomandoj fort shkollën "Udha e
shkronjave", pasi e njoh nga afër si prind.*

Merita Rumano

Jam shumë e kënaqur me metodologjinë
e shkollës dhe përkushtimin e mësuesve.
Ajo i ndihmoi dy vajzat e mia të arrijnë
rezultate shumë të mira dhe performancë
të lartë, kur iu bashkuan shkollave dhe
bashkëmoshatarëve të tyre në Kanada.

Etleva Mullaj

Shkollë e shkëlqyer, mësues të
mrekullueshëm, me të vërtetë të
përgjegjshëm, seriozë dhe të përqendruar.
Jam shumë e lumtur që im bir kaloi aty
nëntë vite.

Matilda Simaku



Shkolla ku mësimi është mësim dhe cilësia
e garantuar. Përgatit me përkushtim
fëmijë të aftë dhe patriotë.

Birkena Zirrjazi



Danieli e ndoqi "Udhën e shkronjave" për
dy vjet. Kur lëvizëm në Londër tranzicioni
për të ishte i lehtë, pasi njohuritë e marra
dhe gjuha sipas programit British ishin në
nivel tepër të lartë. Do ta rekomandoja
"Udha e shkronjave" për të gjithë prindërit
që e konsiderojnë shkollimin si investimin
më të rëndësishëm në jetë.

Elvis Cenka



Është një nga shkollat më rezultative,
lehtësisht e krahueshme me institucio-
net më të mira në botë. Nxënësit dalin të
përgatitur, rrjedhojë e punës së palodhur
të stafit drejtues dhe të atij mësuesor.

Morena Nano

Përmes olimpiadave, “Udha e shkronjave” pati një ndikim të fuqishëm tek nxënësit e shkëlqyer

“Udha e shkronjave” - institucion unik, me staf që punon me dashuri dhe profesionalizëm për të edukuar brezat e rinj. Unë kam marrë pjesë në olimpiadat e tyre dhe kanë qenë gjithmonë të organizuara në mënyrë të shkëlqyer.

Jurgen Kopliku, Shkodër

“Udha e shkronjave” ka qenë gjithmonë një hap përpara. Larmia e sfidave dhe mundësive që u propozohen çdo nxënësi në Shqipëri duhet të duartrokitet. “Udha e shkronjave” ka patur një ndikim të madh në studimet dhe karrierën time.

Kevin Isufaj, Shkodër

“Udha e shkronjave” institucion elitar, ndër më të rëndësishmit që ka Shqipëria. Për sa u përket olimpiadave, do të merrja sërish pjesë në çdo olimpiadë të organizuar nga “Udha e shkronjave”, një nga përvojat më të mira dhe më të vlefshme.

Laura Sheshi, Fier

Olimpiada “Udha e shkronjave” - Një nga përvojat më të bukura dhe më me vlerë të jetës sime. E shoh ndikimin e një olimpiade me nivel të lartë që në moshë të vogël tek unë. Profesionalizmi i drejtuesve është i mrekullueshëm. I falenderoj.

Paola Xhelaj, Fier

Përvoja ime me “Udha e shkronjave” krahasuar me shumë olimpiada të tjera ka qënë e mrekullueshme dhe me standarte të larta që në fillimet e saj. Një staf profesional dhe i dedikuar. Vijoj të ndjek me admirim punën e tyre.

Arba Karçini, Fier

Pranë shkollës “Udha e shkronjave” jemi ndier të vlerësuar, të përrkujdesur dhe të respektuar.

Rezarta Perri, Tiranë

“Udha e shkronjave” është një ndër shkollat më serioze të Republikës. Staf i përkushtuar, me zell ndaj mësimdhënies.

Mario Banushi, Shkodër

Shumë mirënjohës “Udhës së shkronjave” për olimpiadat kombëtare që zhvillonin për fëmijët.

Alboreno Vocaj, Bilisht

Përvojë unike. Olimpiada u dha mundësi fëmijëve të mi për të ballafaquar njohuritë e tyre me bashkëmoshatarët e gjithë Shqipërisë. Vlen të përmendet fryma atdhetare pjesë e pandarë e edukimit.

Gilberto Jaçe, prind, Përmet

Olimpiadat “Udha e shkronjave” na kanë shtyrë përtej kufijve tanë, sepse kurrikula ishte gjithmonë një hap përpara. Regjistrohuni tek kjo shkollë, të bëheni versioni më i mirë i vetes, të përgatitur për universitetet më të mira.

Erin Kërçiku, Julind Xhani, Tiranë

Olimpiadat “Udha e shkronjave” me plot gojën ia kanë vlejtur, jo vetëm për përvojën dhe emocionet që një garë fal, por dhe për edukatën e të mësuarit. Jam mirënjohëse për atë pjesë intensive dhe të mirëpërdorur të fëmijërisë sime.

Nina Ahmetaj, Tiranë

“Udha e shkronjave” - organizuese olimpiadash në mënyrë dinjitoze. Fëmija im ka marrë pjesë disa herë në këto olimpiada dhe çdo gjë ka qenë e përkryer si nga organizimi ashtu dhe nga dijet e marra pasi cilësia ka qenë shumë e lartë.

Altin Zojle, Berat

Ishte radha ime si mësuese për t'i frymëzuar nxënësit e shkollës “Udha e shkronjave”

Isha jo më shumë se 12 vjeç kur mora pjesë në Olimpiadën Kombëtare të organizuar nga shkolla “Udha e shkronjave”. Para se të niste Olimpiada, organizuesi, Artur Shkurti, mbajti një fjalim të shkurtër. Pavarësisht emocioneve që kisha para testit e dëgjova me vëmendje dhe fjalët e tij qëndruan gjatë me mua. Teza që plotësova më bëri shumë përshtypje. Pasi edhe pse deri në atë moment kisha marrë pjesë në shumë olimpiada dhe konkurse, kuptova se pyetjet ishin të një niveli tjetër, të një niveli për të cilin shumicat e shkollave në Shqipëri nuk ishin ende gati.

Pasi u largova nga Shqipëria për të ndjekur studimet e larta, bëhej më i qartë për mua fakti se ishin pikërisht këto olimpiada që të përgatitnin për vështirësitë e programeve në universitetet e Europës, por edhe më gjerë.

Prandaj, kur u ktheva përsëri në Shqipëri, për të dhënë ndihmesën time në vendin tim, e dija se doja të punoja me njerëz që kishin një qëllim dhe vizion me mua: *Të investojmë maksimalisht në arsimimin e nxënësve shqiptarë, për t'i drejtuar ata drejt së ardhmes që meritojnë.*

Mundësia për të punuar në shkollën “Udha e shkronjave” më erdhi krejt papritur, por unë isha e vendosur që në momentin e parë të bëhesha pjesë e këtij institucioni që më shumë se dhjetë vite më parë më kishte ndryshuar mënyrën se si i shikoja programet dhe olimpiadat në Shqipëri. Puna këtu më vërtetoi pikërisht këtë fakt: “Udha e shkronjave” nuk është si shkollat e tjera. Prej vitesh, kjo shkollë ka ndërtuar dhe ka ruajtur një standard që është i vështirë të arrihet dhe të gjendet në shkollat e tjera.

Puna e palodhur e drejtuesve dhe mësuesve, përkushtimi i jashtëzakonshëm për vazhdimësinë e çdo nxënësi, programi fantastik dhe serioziteti me të cilin zhvillohen të gjitha lëndët janë disa nga elementet kryesore që mbajnë të lidhur fort themelet e kësaj shkolle që ka vetëm një synim të palëkundur: *të ndihmojë këta nxënës të zgjedhin rrugën e dijes dhe të shkëlqejnë në atë që ata dinë të bejnë më mirë.*



Për mua ka qënë një privilegj të kem mundësinë të punoj me këtë staf kaq të përgatitur që më ka ndihmuar të rritem profesionalisht dhe me këta nxënës të mrekullueshëm që ma kanë bërë punën kaq të bukur. *Në një mjedis ku mbizotëron harmonia, mirëkuptimi dhe dëshira për sukses, puna nuk u bë për mua kurrë e lodhshme.*

Do u jem gjithmonë mirënjohëse drejtuesve të shkollës “Udha e shkronjave” që më bënë pjesë të një përvoje të tillë dhe që më rikujtuan se pavarësisht vështirësive që përballet sot vëndi ynë, misioni i arsimit duhet të mbetet përherë i palëkundur. *Do u jem gjithmonë mirënjohëse edhe nxënësve të mi, që më lejuan të jem pjesë e botës së tyre. Te ata pashë veten time shumë vite më parë dhe e dija se tani ishte radha ime për t'i frymëzuar, për t'u kujdesur për ta dhe për t'i përgatitur që të bëhen versioni më i mirë i vetes kudo që të shkojnë.*

U uroj shumë suksese dhe i ftoj të gjithë nxënësit vizionarë dhe të shkëlqyer të bëhen pjesë e kësaj përvoje që do t'u vlejë gjithë jetën.

Benilva Zoga

Mësuese e anglishtes
qershor, 2025

Punova tek “Udha e shkronjave” me shumë kënaqësi dhe motivim

Një nga sfidat më të rëndësishme të një shkolle për të ruajtur një edukim me cilësi të lartë është të gjeturit, zhvillimit dhe mbajtjes së një stafi efektiv mësuesish. Cilësia e mësimdhënies nuk varet vetëm nga mbulimi me sukses i përmbajtjes së lëndës nga ana e mësuesit, por edhe nga mënyra se si ndihet një mësues në mjedisin e punës.

Kam 6 vite që punoj në shkollën ‘Udha e shkronjave’ si mësuese matematike dhe mund të them që kam punuar me shumë kënaqësi dhe motivim.

Ka disa faktorë që ndikojnë në krijimin e një mjedisi ideal për mësuesit dhe në këtë artikull dua të veçoj disa nga faktorët që mendoj që bëjnë shkollën ‘Udha e shkronjave’ një mjedis shumë të mirë pune.



Drejtoria kupton sfidat e mësuesve dhe mbështet

Të qënurit e të dy drejtuesve të shkollës me profesion mësues, dhe përfshirja e tyre në mësimdhënie, e bën më të lehtë të kuptuarin e sfidave që kanë mësuesit në punën e përditshme dhe zgjidhjen më të shpejtë të problematikave që mund të dalin. Diskutimi i hapur ndërmjet stafit dhe drejtorisë bën të mundur që mësuesi të ndihet i përfshirë në menaxhimin e situatave.

Mjedis i ngrohtë pune

Bashkëpunimi ndërmjet mësuesve është një nga pikat kryesore që ndihmon në zhvillimin e shpejtë të performancës së secilit mësues. Krijimi i një marrëdhënieje të mirë ndërmjet stafit bën që mësuesit të ndajnë me njëri tjetrin përvojat dhe mendimet e tyre dhe të krijojnë një mjedis të ngrohtë pune.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Ofrimi i mundësisë për një zhvillim profesional bën të mundur që mësuesi të ndihet më konfident në punën e tij, më i motivuar për të sjellë risi në mësimdhënie. Jam e kënaqur që kam patur mundësi të marr pjesë në trajnime mbi metodat e reja të mësimdhënies si dhe diskutimin rreth tyre se si mund të përfshihen në procesin mësimor.

Marrëdhënie shumë të mira mësues – nxënës

Marrëdhënia ndërmjet nxënësve dhe mësuesve lidhet direkt me përzgjedhjen e kujdesshme të nxënësve të shkollës. Puna e mësuesit bëhet më e lehtë kur në klasë janë nxënës të gatshëm për të mësuar dhe për të arritur objektivat e lartë që kërkohen nga shkolle. Gjithashtu mjedisi i punës së mësuesit, numri i vogël i nxënësve në klasë bën të mundur që mësuesi t'i kushtojë vëmendjen e duhur secilit nxënës, duke bërë të mundur krijimin e një marrëdhënie të afërt mësues – nxënës dhe duke e bërë të dukshme çdo problematikë që mund të kenë nxënësit, sado e vogël të jetë ajo.

Puna e mësuesit është sfiduese dhe problematikat që lidhen me të janë të pafundme. Por është lehtësuese për punën e mësuesit kur mjedisi ku ai punon ofron kushtet e favorshme dhe është pikërisht kjo gjë çfarë e bën shkollën ‘Udha e shkronjave’ një mjedis ku punon me pasion dhe motivim.

Elira Curri

*Mësuese e matematikës
korrik, 2021*

Shkollë e jashtëzakonshme shqiptare në nivele ndërkombëtare - për shkëlqyeshmëri

Nga Besiana Vathi

Quhem Besiana Vathi, mësuese prej disa vitesh në shkollën “Udha e shkronjave” në Tiranë. Kam dhënë *IGCSE English as a Second Language, IGCSE Art & Design, IGCSE Drama, IGCSE World Literature, Global English, Global Perspectives* dhe *letërsi shqipe*. Duke qënë se kam udhëhequr orët mësimore me rigorozitet dhe, falë mirëgjyimit dhe mirëshqyrimit të drejtorisë, nxënësit kanë arritur nota maksimale në certifikimet IGCSE në vazhdueshmëri. Ndaj, pa zmadhuar ndikimin që ka pasur shkolla tek unë, më ka rritur dhe më edukuar profesionalisht, duke më bërë të mos më shpëtojë asnjë detaj kur bëhet fjalë për punën.



Në realitetin shqiptar sot ekziston dukuria e pantomimeve. Gjithçka bëhet për t'u dukur, por thelbësorja, ose substancialiteti i gjësë mungon. Shohim veshje të bukura ku mungon shtylla e estetikës e të qënurit human, pra, them të kuptosh se ç'është jeta e bukur, me diell, me libra, me biseda të ëmbla, me virtyte të urta. Shohim shkolla që reklamojnë lumturinë e nxënësve të tyre dhe të ekskursioneve të largëta që bëjnë, por sa nxënës prej së vërteti dinë të artikulojnë një debat pa fjalë që varen si të tepërta? Një profesionist i dalluar nuk kënaqet kollaj me çfarë sheh në këtë vend, ku gjërat më së shumti bëhen shkeleshko dhe ku mbizotëron njeriu mediokër. Nxënësit e “Udha e shkronjave” janë të aftë të kuptojnë kleçkat dhe mospërputhjet në shpjegim edhe tek një mësues me përvojë disavejeçare dhe të mirëshkolluar, duke u bërë kjo që ai mësues të gdhënd edhe mendimet e veta kur është në heshtje. Ndaj, kjo shkollë është e veçantë dhe dallon në terrenin tonë të vetëkënaqur.

Shkolla është hapur prej 1997 dhe ka bërë një punë të shkëlqyer me nxënësit e saj. Te shkollimi im është investuar së tepërmi - kam studiuar në Columbia University e cila është tek top 10-ta në botë dhe tek Universiteti i Amsterdemit i cili është tek top 35, ndaj kam mjaft përvojë me cilësitë që duhen në një institucion shkollor, sepse kam parë më të mirët. “Udha e shkronjave” me të vërtetë i përgatit nxënësit e saj për të ndjekur këtë udhë të shkëlqyeshisë së këtyre shkollave. Shkolla të tjera në Tiranë thjesht i vijnë rrotull këtij fakti.

Pikë së pari, le të marrim pak me seriozitet nocionin e “academic honesty” - sinjeriteti akademik. Në shkollat shqiptare është qesharake kjo - në testime kombëtare vetë mësueset japin përgjigjet e pyetjeve, kopjimi është sheshit, merreni me mend seç bëhet. Pyetjet nëpër testime janë prapë të këtij rangi mediokër që sapofolëm. Testimet e shkollës “Udha e shkronjave” i ngjasojnë më tepër atyre të Columbia University se sa Ismail Qemalit. Secili shikon fletën e vetë dhe kopjimi, i cili është kanceri i dijes, ndëshkohet me të drejtë. Edhe mësueset druhen kur thonë një të dhënë që s'është e saktë. Ku nuk studiohej mirë një fakt në Columbia pedagogu rrezikonte vendin e punës - gjithashtu edhe tek “Udha e shkronjave”. Shkolla është një oaz i shkëlqyeshmërisë në një vend që është katandisur i varfër për dije.

Nga përvoja ime si mësuese në shkollë më ka bërë shumë përshtypje si ambient ku secili ka pasionet e veta dhe i ndjek me përkushtueshmëri ato, si nxënësi, prindi, drejtorja, mësuesi. Përveç saktësisë shkencore vihet theks mbi artin, muzikën, librin, sportin. Dhe të gjithë aktorët janë shqiptarë, sepse gjithashtu siç është e rëndësishme të ndërtohet një ndjenjë patriotizmi të amortizuar, ku të thuhet “jam shqiptar”, pa keqardhje të mbytur, por me fakte dhe arritje konkrete.

Kush ka studiuar tek “Udha e shkollave”, dhe ka ndjekur këshillat e mësuesve aty, ka arritur majat e ekselencës akademike. Nëse doni të kaloni rradhën dhe të gënjeheni me spektakle, kjo shkollë nuk është për ju. Por, nëse doni që fëmija të bëhet dikushi dhe të konkurojë denjësisht më botën, atëherë nuk ka mirë se “Udha e shkronjave”.



Nga Abdi Baleta

*Librat “Besa” dhe “Gjuha shqipe” të Artur Shkurtit
një sukses i shkollës “Udha e shkronjave” dhe sukses
i mendimit arsimor, i mendimit politik dhe filozofik shqiptar*

*Nga fjala më 25 maj 2015, në promovimin e librave të Artur Shkurtit
“Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë” dhe “Gjuha shqipe”*

Është një nder i shkollës, besojmë që kjo është ceremoni e përvitshme që organizon “Udha e shkronjave” që s’ka qenë udhë e lehtë as atëherë kur duheshin nxjerrë shkronjat dhe nuk ka qenë dhe nuk është udhë e lehtë as për shkollën “Udha e shkronjave” tani, duke patur parasysh se çfarë ka hequr kjo shkollë gjatë shumë viteve. Unë të përgëzoj shumë për rezistencën, të përgëzoj për punën e madhe, të përgëzoj edhe për librat (“Besa” dhe “Gjuha shqipe”).

1 takonte që këtë punë që ka bërë “Udha e shkronjave” ta bënte universiteti, besoj, ta bënte Akademia e Shkencave.

Mua më duket se një paraqitje të tillë të mendimeve të Naimit, siç e ka bërë Arturi, në këto dy libra ma merr mendja nuk është bërë.

Nj ë antologji e mendimit kombëtar, politik, moral, moralizues; të gjitha që ka patur Naimi janë ndërtuar në një formë shumë shumë të veçantë. Libri “Besa” këtë e tregon.

Do të ndalem më shumë tek “Gjuha shqipe” se kjo është më pak e njohur. Vlerësoj se ka një bashkëngjitje të të gjithë korifejve të Rilindjes sonë Kombëtare në atë libër, por boshti është Naimi dhe Samiu që janë bashkë. Naimi dhe Samiu nuk ndahen dot; mund të ndahen në letërsi, por në mendimin politik, filozofik shqiptar Naimin dhe Samiun nuk i ndan dot.

Këtë studim do ta quaja një sukses të kësaj shkolle dhe një sukses të mendimit arsimor dhe mendimit politik dhe filozofik shqiptar.





Për Naim Frashërin dhe Rilindjen Kombëtare **Deputeti Bujar Leskaj përcjell në Kuvendin e Shqipërisë** **shqetësimet e shkollës “Udha e shkronjave”**

Diskutimet këtu më shtyn mua të sjell në vëmendje të deputetëve të Komisionit të Kulturës dhe deputetëve të Komisionit të Arsimit, dhe shumë mirë që është këtu edhe ministri, disa materiale që janë përcjellë përmes e-mail-it nga një personalitet do ta quaja unë i arsimit kombëtar, themelues dhe drejtues shkolle, dhe hartues tekstesh në arsimin 9-vjeçar, zoti Artur Shkurti. Këto ju kanë ardhur të gjitha, kanë shkuar tek të gjithë deputetët.

Mua më tërhoqi vëmendjen për një gjë, se edhe këndvështrimi im është që Ligji 27 i vitit 2018 “Për trashëgimitë kulturore dhe muzetë” në pjesë të veçanta të tij, është tamam ligj “i qepur me dorë” për të lënë këto hapësirat për abuzime të mëtejshme. Dhe ky studiues na tërheq në vëmendjen si parlamentarë dhe unë do të përcjell tre pikat kryesore dhe nuk marr përsipër sa të drejta janë këto.

Ju inkurajoj si deputetë të Komisionit të Arsimit dhe të Kulturës ta ftoni në Komision zotërinë në fjalë dhe të japë shpjegime më të plota.

Së pari, zoti Artur Shkurti akuzon politikën shqiptare në këto vite për sulm ndaj “Mësonjëtores së parë shqipe”. Sulmi ndaj “Mësonjëtores” u fillua në maj 2018 me ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe u përfundua në 2021 me VKM 146 datë 10 mars 2021 me mbylljen e muzeut të vjetër dhe hapjen e të riut dhe me status të ndryshuar.

Së dyti, në e-mail-et që ka përcjellë dhe materialet që ka përcjellë zoti Shkurti ngre shqetësimin e madh kombëtar për sulme ndaj Poetit Kombëtar Naim Frashëri, të cilat filluan me ligjin 93/2022, ligji i famshëm për dekoratat, që në fakt hoqi Urdhrin “Naim Frashëri” dhe përfunduan me miratimin e ligjit në vitin 2024.

Dhe së treti, sulmi ndaj 7 marsit është përmbledhja e të gjithë këtyre, që është zëvendësimi i 7 marsit 1887 të Rilindjes Kombëtare me 22 nëntorin 1908 që është brezi i dytë i rilindasve kombëtarë. Dhe kalimi nga shkombëtarizimi i Korçës i 1887 dhe kalimi tek Manastiri 1908.

Nga ana tjetër, tërheq vëmendjen studiuesi, ne duhet të përqëndrohemi fort të ngremë vlerat, ta ngremë në piadestalin e merituar Poetin e madh Kombëtar Naim Frashëri dhe unë do të shtoja edhe poetin e madh Gjergj Fishta, si edhe t’u japim vendin e duhur ideologëve Sami Frashëri dhe Pashko Vasa.

E përsëris ky ishte ngacmim nga e-mail-et dhe materialet që ka përcjellë zoti Shkurti.

Kuvendi i Shqipërisë
Tiranë, më 19 shkurt 2026



Referenca e Ministrisë së Arsimit për shkollën “Udha e shkronjave”

Provimet shtetërore

Provimet e Lirimit janë mënyra e vetme që ka Ministria e Arsimit për të dhënë një rezultat konkret të cilësisë mësimore, me anë të të cilit shkollat mund të krahasohen me njëra-tjetrën.

Në shtatë vitet e fundit mesatarja jonë është 9.5.

Kjo na rendit në vendin e parë në Shqipëri në këtë parametër.

Në 2025, vendosëm rekord kombëtar:

Nota 10 në matematikë. Nota 10 në gjuhë shqipe. Nota 10 në anglisht.

Rezultatet tona janë qartësisht të qëndrueshme.

Bashkëpunimi me shkollat publike dhe zyrat arsimore

Për vite me radhë drejtoritë e shkollave shtetërore, por edhe zyrat arsimore, ndanin ftesat tona të Olimpiadave Kombëtare.

Fitues në konkurset e ministrisë për tekstet të shkëlqyera mësimore

Teksti bazë “Matematika 6” (Teori dhe Ushtrime) nga “Udha e shkronjave”, me autor **Artur Shkurti** dhe **Sitki Spahia** u shpall fitues në konkursin kombëtar të teksteve për vitin 2005. U shpall e vetmja alternativë fituese. Ky tekst mësimor bazë u zbatua në 100% të shkollave private dhe shtetërore për dy vjet (2005-2007).

Teksti mësimor “Dituria e natyre klasa 3” nga “Udha e shkronjave” me autorë **Artur Shkurti** dhe **Mirela Shkurtin**, fitoi konkursin për tekstin mësimor “Dituri natyre klasa 3”, duke marrë 97 pikë nga 100 të mundshme. Libri pati shumë shkëputje në cilësi dhe u zgjodh alternativë e vetme fituese.



Provimet Shtetërore të Lirimit për vitin 2025

- Gjuhë shqipe 10 (100%)
- Matematikë 10 (100%)
- Anglisht 10 (100%)





RITI I IDENTIFIKIMIT TË SHQIPTARËVE

Autor Artur Shkurti, Libri "Besa", 2009, fq.32



Me zëmrë shumë të qetë,
lith duart në kraharruar,
pa thotë "Zot i Vërtetë!
Emri yt qoft i lëvdhuar"



Naim Frashëri
"Histori e Skënderbeut", 1898



INFO:
0692076068



Zgjidh filloren
"UDHA E SHKRONJAVE"
5-11 vjeç




Klasa 0 - 5 "Udha e shkronjave"
*ndjek nivelet 1-6 të Cambridge Primary dhe disa
programe kombëtare të "Udha e shkronjave"*

"Udha e shkronjave" ofron një mirëqenie të lartë fizike dhe mendore në klasa të vogla me nga 6 nxënës.

Përgatitja e shkëlqyer mësimore bëhet bazë për të tërë jetën. Nxënësit edukohen me dashurinë për dijen dhe me tiparet e karakterit punëtor dhe sistematik. Ofrojmë programe të shkëlqyera të Kembrixhit në lëndët: anglisht, matematikë, shkencë, Global Perspectives, shkencë kompjuteri, aftësim digjital, art-dizajn, muzikë, edukim fizik.

Programet nga "Udha e shkronjave": abetare, gjuhë shqipe, problemzgjidhje, matematikë bëjnë që të zhvillohet kultura shqiptare e formimit akademik të nxënësit.





Zgjidh parashkollorin “Udha e shkronjave”



Kryen nivelin 1 të Cambridge Primary

(anglisht, matematikë, shkencë, Global Perspectives,
art-dizajn, muzikë, sport, shkencë kompjuteri)
dhe disa programe kombëtare
të shkollës “Udha e shkronjave”
(abetare, matematikë, edukatë, dituri natyre)



**Na kontaktoni
në 0692076068**

**Cambridge
Primary**



Zgjidh klasat 6-7-8



Cambridge
Secondary 1

Cikli II

Klasat 6-7-8 mosha 11-14 vjeç





Klasat 6,7,8 formojnë cikël më vete, me kombinim të programeve Cambridge Lower Secondary dhe programeve kombëtare. Mbi 10 lëndë janë Cambridge: Global Perspectives, anglisht, italisht, matematikë, biologji, kimi, fizikë, art-dizajn, muzikë, edukim fizik, shkencë kompjuteri, aftësim digjital.

Nxënësit dëshmojnë nivel të lartë të mirëqënies. Mësimi i cilësisë së lartë, mbështetja për çdo nxënës, e përmirësojnë ndjeshëm mirëqënien e kompetencës. Marrdhëniet e nxënësve ndërmjet njëri-tjetrit dhe me stafin ndikojnë mirëqënie të lartë të marrdhënieve ndërpersonale. Komuniteti i nxënësve ka nivel të lartë sjelljeje. Kjo ndikon thellësisht mirëqënien për shkak të mungesës së emocioneve negative. Veprimtaritë dhe e gjithë shkolla ndikon kënaqësinë për jetën.

Zhvillimi fizik është i shkëlqyer Bëjmë 5 orë mësimore në javë, pra 65% më shumë orë edukimi fizik sesa programi shtetëror. Klasat 9-10 e kanë certifikuar këtë lëndë me Cambridge IGCSE. **Zhvillimi artistik** është nivel i lartë, i garantuar nga kurrikula ndërkombëtare dhe tradita e shkëlqyer e shkollës. Kemi certifikuar ndërkombëtarisht Art-Dizajn dhe Dramë me Cambridge IGCSE.

“Udha e shkronjave” ka hartuar **programet dhe tekstet e saj mësimore origjinale.** Kujtojmë që Matematika 6 me autor Artur Shkurti & Sitki Spahia fitoi konkursin e Ministrisë së Arsimit dhe u përdor nga 100% e shkollave në 2005-07. Rezultatet tona për klasat 6-8 janë 25-30% më të larta se mesatarja globale e shkollave të Kembrixhit në anglisht, matematikë dhe shkencë, global Perspectives. Kjo provohet me raportet e Cambridge Progression Tests dhe Cambridge Checkpoint.



HISTORI SUKSESI NDËRKOMBËTAR

Në klasën 9 dhe 10, nxënësit "Udha e shkronjave" tregojnë një sukses të jashtëzakonshëm me programet me programet Cambridge IGCSE. Ata kryejnë të paktën 7 lëndë IGCSE dhe pasi japin edhe provimet përkatëse marrin edhe dëftesën ndërkombëtare Cambridge ICE dëftesa ndërkombëtare më e njohur në botë.

Ministria e Arsimit! Na vlerëson me 10!

Klasa 9 "Udha e shkronjave" merr dëftesën e njohur nga Ministria e Arsimit në përfundim të provimeve shtetërore. Në 2025, klasa e nëntë vendosi rekord kombëtar në provime lirimi duke u vlerësuar **çdo nxënës me notën 10 në çdo lëndë**. Kemi qëndrueshmëri në rezultate të larta. Nota 9.5 është mesatarja jonë në shtatë vitet e fundit në Provimet Shtetërore.

Klasa 9, katër certifikime IGCSE

Klasa e nëntë, përveç programit shtetëror, mëson e kualifikohet me katër certifikime Cambridge IGCSE. **Në vitin 2025 vendosëm rekord.** Klasa IX me gjashtë certifikime IGCSE dhe dëftesën Cambridge ICE, dëftesa ndërkombëtare më popullore në botë.

Dëftesë Cambridge ICE në klasën 10

Për ta marrë dëftesën ICE, klasa jonë e dhjetë kualifikohet në 7 lëndë me certifikime IGCSE. Deri më sot **80% e nxënësve tanë** e kanë marrë dëftesën ICE me vlerësimin "Distinction". **Kemi dhënë 22 dëftesa ICE.** Klasa 10 është trampolinë për të kaluar në kolegje ndërkombëtare (IB Diploma, AICE etj).

Mbi 1 milionë euro është vlera e bursave në pesë vitet e fundit, 2022-2026, të fituara nga nxënësit tanë klasa 10.

Aplikime të mbështetura fuqishëm nga shkolla

Drejtorja "Udha e shkronjave" i udhëheq nxënësit, klasa 10, në aplikime, duke konceptuar për dy vjet (klasa 9-10) argumentat, dëshmitë, sfidat dhe performancën. Dyvjeçari mbushet me veprimtari të planifikuara mësimore edukative të përputhura me dëshirat e nxënësit dhe familjes që bëhen kështu argument i fuqishëm i dosjes së nxënësit.

Drejt Diplomës IB ose AICE (pas klasës 10)

Tek "Udha e shkronjave" në klasën e dhjetë 100% e nxënësve aplikojnë për pranim dhe bursa në kolegje të shkëlqyera ndërkombëtare, të cilat ofrojnë Diplomën IB ose AICE, në dy vjet, pra në klasat 11 dhe 12.

AGNES METANI - REKORD CERTIFIKIMESH

Agnes studion në klasën 10. Në klasën e nëntë ajo përfundoi me sukses tetë certifikime lëndore IGCSE me vlerësim A*, mesatare 96%, dhe dëftesën Cambridge ICE me "Distinction". **Lëndët e certifikuara prej saj:** Global Perspectives, Matematikë, Fizikë, Shkencë kompjuteri, Anglisht, Gjermanisht, Italisht. Në proces janë biologji, kimi, art-dizajn, letërsi botërore (IGCSE) matematikë (A Level).



Shmangia me sukses e konfliktit të interesit

Shkollat private e përfundojnë vetë punën deri në maturë. Natyrshëm, ato nuk kanë interes të nxitin nxënësit të aplikojë diku tjetër. Kështu konflikti i interesit, i natyrshëm për atë shkollë, bëhet i panatyrshëm për interesin e nxënësit. "Udha e shkronjave", e përfundon punën e saj në klasën e dhjetë. Kështu shmang "konfliktin e interesit". Në pamje të parë duket ofertë "më e varfër".

Një keqkuptim. Në fakt, është pika më e fuqishme e ofertës "Udha e shkronjave" në interes të nxënësit dhe familjes. Është sukses!

Bursat që marrin nxënësit variojnë 35000 - 80000 euro dhe për shkollat e Zvicrës shkojnë mbi 280 000 euro (Aiglon & Leysin). Aplikimet në kolegjet e tjera të shkëlqyera ndërkombëtare janë në objektivat e shkollës "Udha e shkronjave". Ne punojmë disa vjet me këtë objektiv.



KURRIKULA IGCSE

Cambridge IGCSE u krijuan 30 vjet më parë nga Kembrixhi. "Udha e shkronjave" ka 14 vjet që i përdor këto programe në klasat 9-10 dhe ndonjëherë edhe në klasën e tetë.

Cambridge IGCSE ofrohet në shumë lëndë dhe "Udha e shkronjave" ka një rekord në numrin e lëndëve të mësuara dhe të certifikuara: Gjuhët anglisht, gjermanisht, italisht, frëngjisht; matematikë; shkenca humane dhe sociale: Global Perspectives, letërsi botërore; lëndë profesionale apo të krijimit: shkencë kompjuteri, TIK, art-dizajn, edukim fizik, dramë, kontabilitet, ndërmarrje, udhëtime dhe turizëm.



Cambridge A Level

për gjimnazistë të klasave 11, 12

Cambridge
International
A Level

0692076068

Nensi Shkurti u pranua në Kanada (2018) në **Universitetin e Torontos**. Përfundoi studimet për **Menaxhim & Financë** me **High Distinction**. (2022)

Tek "Udha e shkronjave" mësoi e mori:
7 certifikime Cambridge IGCSE, nota A*
3 certifikime Cambridge A Level, nota A*

Cambridge IGCSE:

Mathematics, Physics, Computer Science,
ICT, Chemistry, Accounting, English.

Cambridge A Level:

Mathematics, Law, Accounting




Erin Kërçiku dhe Julind Xhani u pranuan në **Universitetin Teknik të Mynihut TUM** (2021) për **Shkencë Kompjuteri** dhe **Elektronikë**.

Nxënës të shkollës "Fan Noli" dhe të gjimnazit "Sami Frashërit". Pranë "Udha e shkronjave" mësuan për dy certifikime **Cambridge IGCSE** dhe një Cambridge A Level.

Cambridge IGCSE: Mathematics (A*), ICT (A)

Cambridge A Level: Mathematics (A*)



Where will the Cambridge
Pathway take you?

#CAMBRIDGELEARNERS

Posteri më sipër është realizuar nga *Cambridge International Education*, më 22 shtator 2018, dhe u botua në rrjetet e tyre sociale, shoqëruar me njoftimin për pranim në Universitetin e Torontos:

"A fantastic student success story from Albania. Nensi Shkurti has just begun her studies in Business Administration at the University of Toronto following twelve years at "Udha e shkronjave" - one of our schools in Tirana, Albania - where she achieved excellent results."

Statusi i Kembrixhit mbështet argumentimin se kualifikimet Cambridge A Level janë argument i fuqishëm për t'u pranuar në universite të toplistës botërore.



Cambridge A Level parashikohet të bëhet në dy vitet e fundit të shkollës së mesme (klasa 11, 12).

Matematika A Level tek "Udha e shkronjave" ka dy vjet që fillon që në klasën e dhjetë me As Level, ku mësojmë *Pure Maths 1,2 dhe/ose Statistics & Probability 1*. Nxënësit tanë që më vonë studiojnë për IB Diploma ose AICE Diploma fitojnë kohë të mjaftueshme për sukses të mtejshëm në mësimet dhe aplikime për bursa e universitet.

Cambridge International AS & A Level zhvillon njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë e nxënësve në:


përmbajtje të thelluar lëndore, të menduarit e pavarur, zbatimin e njohurive dhe të kuptuarit në situata të reja, si dhe të njohura, trajtimin dhe vlerësimin e llojeve të ndryshme të burimeve të informacionit, të menduarit logjik dhe prezantimin e argumenteve të renditura dhe koherente, dhënien e gjykimeve, rekomandimeve dhe vendimeve, paraqitjen e shpjegimeve të arsyetuara, kuptimin e implikimeve dhe komunikimin e tyre logjik dhe të qartë, punën dhe komunikimin në anglisht.

Programi i edukimit të karakterit dhe virtyteve

Virtyte intelektuale, morale, qytetare, të performancës dhe urtësia

“Udha e shkronjave” ka program të vetin për edukim të karakterit dhe të virtyteve. Kemi përgatitur literaturën për të realizuar këtë edukim në të katër komponentët e virtyteve: intelektuale, morale, qytetare dhe të performancës, me librat “BESA” (2009) dhe “Dituria e moralit” (2025)

Nxënës, prindër, mësues dëshmojnë programin e edukimit të karakterit



Dr. Olta Mersini, mjeke, identifikon edukimin e virtytit intelektual:


“Profesionalizmi i tyre, respekti i tyre për jetën dhe dashuria për librat që u jepet të gjithë fëmijëve, vështirë se gjendet sot.”

Arlind Tandili, student mjekësie, në Bolonjë, identifikon situatën që ka nevojë për virtytin e performancës:

“Duhet thënë që përballja me programet e përparuara ndërkombëtare ishte një malore e fortë.”

“Mësuesit janë shumë të kualifikuar dhe të ndihmojnë jo vetëm me punën akademike, por edhe për të krijuar një karakter me virtyte.”

Jora Demaj, studente,
(KU Leuven, Belgjikë)



Pegi Mara, studente në Duke University, thekson virtytin e performancës dhe virtytin moral:

“I jam shumë mirënjohëse “Udhës së shkronjave”; prej saj ndihem më se gati për të përballuar sfidat që më presin në të ardhmen. Ua rekomandoj këtë shkollë të gjithë nxënësve që duan një jetë akademike sfiduese e tepër të frytshme dhe njëkohësisht të krijojnë miqësi të forta e të qëndrueshme.”

Genta Hoxha dëshmon virtytin intelektual, virtytet morale dhe virtytet e performancës.

“Mbi të gjitha, gjithsecili trajtohet në mënyrë të barabartë dhe puna e mirë shpërblehet. Personalisht, kam qenë shumë e kënaqur, pasi kjo shkollë na ka mësuar se si të mësojmë, se sa e rëndësishme është disiplina dhe puna e fortë, gjë që e mbaj edhe sot e kësaj dite me vete.”

Dr. Merita Rumano, prind, dëshmon këtë program edukimi:

*“Shkolla organizon veprimtari të shumta me **vlera edukative**”.*

Prof.Dr. Birkena Qirjazi, prind, thekson virtytin qytetar (patriotizmin):

*“Përgatit me përkushtim fëmijë të aftë dhe **patriotë**.”*

Gilberto Jaçe, prind i Olimpiadës, ish-kryetar i bashkisë Përmet:

*“Vlen të përmendet **fryma atdhetare pjesë e pandarë e edukimit**.”*



Benilva Zoga, mësuese e shkollës, dikur nxënëse e olimpiadës “Udha e shkronjave”, identifikon situatën që kërkon virtytin intelektual, të performancës dhe kushtin e edukimit harmoninë dhe mirëkuptim.

“Këto olimpiada të përgatitnin për vështirësitë e programeve në universitetet e Europës, por edhe më gjerë”. “Në një mjedis ku mbizotëron harmonia, mirëkuptimi dhe dëshira për sukses, puna nuk u bë për mua kurrë e lodhshme.” “tani ishte radha ime për t’i frymëzuar, për t’u kujdesur për ta dhe për t’i përgatitur që të bëhen versioni më i mirë i vetes kudo që të shkojnë”.

Shkolla Online “Udha e shkronjave”

Regjistruar nga Cambridge International Education më 2022

Ofrojmë Mësim Online me programe ndërkombëtare nga Cambridge International Education

Cambridge
Primary

Cambridge
Secondary 1

Cambridge
IGCSE

Cambridge
International
A Level



“Udha e shkronjave” është ndër shkollat e para në botë që u miratua nga Cambridge International Education, si **Cambridge Online School** (2022), pas pandemisë, për zhvillimin online të programeve të Cambridge për moshat 6–18 vjeç, klasat 1–12, në lëndë të ndryshme mësimore.

Cambridge International certifikoi mësimin tonë online si të suksesshëm, pas vlerësimit të vizionit, historikut dhe vëzhgimit të drejtpërdrejtë të orëve mësimore. Suksesi ynë u dëshmuar veçanërisht në vitet 2020–2022, gjatë pandemisë, me 8 muaj mësim 100% online.

Gjatë pandemisë, klasat 1–10 zhvilluan 6 orë mësimore në ditë, e hëna - premte, ora 9:00–14:00, me 100% të lëndëve (përfshirë fiskulturë, art dhe muzikë), në mësim sinkron përmes Google Meet, duke garantuar mbrojtje të shkëlqyer nga Covid-19.

Info: 0692076068 - udhaeshkronjave.com



Mësimi sinkron zhvillohet në kohë reale, ku mësuesi dhe nxënësit janë të lidhur njëkohësisht në platforma online.



Mësimi asinkron **nuk zhvillohet në kohë reale**; nxënësit mësojnë në kohën e tyre, sipas ritmit personal.

“Udha e shkronjave” Online - një sukses kombëtar

Mësimin online e kemi nisur që në vitin 2010, duke e kthyer *Matematikën Online* në lëndën më të ndjekur. Shkolla “Udha e shkronjave” ishte ndër të parat shkolla shqiptare që iu drejtua mësimin online në kohë krizash natyrore.

Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, realizuam dy javë mësim online të plotë. Më 24 shkurt 2020, për shkak të rrezikut nga përhapja e Covid-19, vendosëm të kalonim 100% online për të gjitha klasat 1–10. Ndërkohë që shumica e shkollave zhvilluan mësim online vetëm 3 muaj, “Udha e shkronjave” realizoi 5 muaj më shumë se çdo shkollë tjetër private apo shtetërore. Edhe në vitin pasues, nga 6 nëntor 2020 deri më 6 prill 2021, mësimi u zhvillua sërish 100% online.

Falë cilësisë së mësimin online, mbrojtëm shëndetin e nxënësve. Vendimi ynë i hershëm u përball fillimisht me kundërshtime institucionale, por prindërit, opinioni publik, opozita, prokuroria dhe gjykata mbështetën shkollën, duke e konfirmuar qartë se vepruam në interesin më të lartë të fëmijëve.

6 nxënës në klasë

 Cambridge Assessment
International Education
Cambridge International School



Nxënësit e rinj: Regjistrimi dhe kursi i përshtatjes

Kursi i përshtatjes nuk është për nxënës të dobët, por për diferencën e programeve

Regjistrimi në shkollën tonë mund të kryhet në moshat 5-16 vjeç.

Regjistrimi i hershëm është një ndihmë shumë e madhe për përshtatjen e nxënësit me shkollën.

Ne e fillojmë punën menjëherë në çastin e regjistrimit dhe deri në shtator kur fillon shkolla realizojmë shumë punë përgatitore.

90% e nxënësve të rinj kryejnë kursin e përshtatjes me shkollën

Ne kemi programe më të përparuara në krahasim me 98% të shkollave publike dhe private dhe po ashtu klasat janë kompakte. Kjo diferencë me shkollat e tjera shpesh shkon në të paktën një vit shkollor.

Për të zbutur këtë diferencë kemi parashikuar një Kurs të Përshtatjes me shkollën, që mund të jetë deri në 100 orë mësimore individuale. Alternativë ndaj Kursit të Përshtatjes është që vetë familja të pretojë që do ta bëjë këtë punë në monitorimin e shkollës.

Përfitimet e nxënësit dhe të prindit nga Kursi i Përshtatjes

Nxënësi plotëson “diferencën”, “hendekun” që ekziston ndërmjet shkollës dhe formimit të tij.

Nxënësi merr mënyrën tonë të të mësuarit me ritëm të lartë.

Nxënësi fiton sigurinë në marrëdhëniet e tij me stafin mësimor.

Nxënësi hyn i sigurt në shkollë sepse ka një ide shumë të qartë mbi shkollën.




“Udha e shkronjave” organizon
Olimpiadën Kombëtare më të madhe në Shqipëri











“Udha e shkronjave” ka botuar tekste mësimore dhe ndihmëse për shkollën dhe për Olimpiadën Kombëtare












“Udha e shkronjave” ka botuar tekste mësimore dhe ndihmëse për shkollën dhe për Olimpiadën Kombëtare



“Udha e shkronjave” ka botuar libra për Edukimin Kombëtar, Moral, për Diasporën dhe refleksime për Rilindjen Kombëtare





Abetarja “Udha e shkronjave” (2001) ka patur vlerësimet më të shumta nga mësuesit

Elena & Ismail Kadare:




“Duam të falenderojmë “Udhën e shkronjave” për atë dritë e gëzim, që na sjell në shtëpiat tona me abetaren e mrekullueshme me të cilën i mësojnë ne Doruntinës së vogël gjuhën e bukur shqipe”. (Panairi i Librit, Prishtinë, 2002)



Rexhep Zillatku, gazetar Maqedoni e Veriut

“Abetarja “Udha e shkronjave” është një vepër e mrekullueshme, dhurata më e mirë që gjyshërit mund t’u bëjnë nipërve e mbesave të tyre. Rrallë vepër ka një shqipe kaq të kulluar e të rrjedhshme, natyrën e saj të vërtetë, kumbimin e bukur. Abetarja është një këngë pa mbarim, është një lumë që gurgullon e të kënaq shpirtin.”

“Matematika 6” Artur Shkurti & Sitki R. Spahia
u shpall tekst fitues më 2005-2007 nga Ministria e Arsimit
dhe ishte teksti i vetëm që mësohej nga 100% e shkollave publike dhe private





Drejtor
Artur Shkurti
Orkestrimi & Regjistrimi
Adrian Hila
Përgatiti korin
Evgjeni Gashi

Kori "Udha e shkronjave" (2004) **Albumi "Zëri i atdheut"**

Album me dhjetë këngë patriotike
më i ndjekuri në YouTube nga shkollat



- Dua më shumë Shqipërinë
- Kënga e Shoqërisë patriotike "Dëshira"
- Sa të rrojë gjithësia
- Porsi Fleta
- Alfabeti Shqip
- Kurrë neve të mos harrojmë
- Për mëmëdhenë
- Zani i atdheut
- Himni i flamurit
- Mëma jonë Shqipëri



25 maj - dita e Naim Frashërit

Tradita jonë për nderimin e Vëllezërve Frashëri dhe të Rilindjes Kombëtare



25 maj - dita e Naim Frashërit

Tradita jonë për nderimin e Vëllezërve Frashëri dhe të Rilindjes Kombëtare



200-vjetori Pashko Vasës

Shkodër, 17 shtator 2025, familja dhe "Udha e shkronjave"









UDHA E SHKRONJAVE
CAMBRIDGE
INTERNATIONAL
SCHOOL





LIDHJA E FISEVE TË SHKODRËS

ORGANIZUAR NGA “UDHA E SHKRONJAVE”
në bashkëpunim me Familjen e Pashko Vasës (30 gusht 2026)

Elena Zef Zorba: “Një veprimtari patriotike ashtu siç edhe emri i shkollës që drejtohet nga z. Artur. Kënaqësi që mora pjesë.

Mojs Tano Banushi: “Unë, Mojs Banushi, mora pjesë në këtë veprimtari të organizuar nga shkolla “Udha e shkronjave” dhe Familja VASA. Vërej se aktivitete të tilla që thellojnë njohuritë për familjet e fiset në Shkodër, janë të bukura e të mirëpritura! Ju faleminderit profesor Artur Shkurti që na doni e na nderoni SHKODRËN!

Manjola Demiraj: “Kënaqësi kjo mbledhje për bashkimin e fiseve shqiptare duke dhënë secili më të mirën si familje, si trashëgues i vlerave më të mira të fisnikërisë, trashëgimisë, kulturave më të mira që i shërbejnë Shkodrës e kombit”

Martin Pjetri: “Mësova në këtë takim mbi fiset idetë e kohës! Falemnders!”

Zef Prela: “U befasova nga ky aktivitet tek shtëpia e Pashko Vasës. Mirëpresim aktivitete të tilla. Një ditë e bukur për Idenë “FISI”.

Muammar Vuci: “Një ditë me frymëzim!”

Marçel Vasa:

Me respektin më të madh për iniciativën tuaj fisnike, që synon lidhjen dhe bashkimin e fiseve shqiptare, të cilat ndër vite i kanë dhënë atdheut burra e gra që e kanë dashur dhe mbrojtur atë si gjënë më të shtrenjtë. Uroj me gjithë zemër që shtëpia jonë, ku lindi Pashko Vasa, një nga figurat më të mëdha të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të jetë për ju një burim frymëzimi dhe t’ju ndriçojë rrugën në këtë mision të shenjtë për të ngritur, ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi vlerat tona më të larta kombëtare.



LIDHJA E FISEVE TË SHKODRËS

ORGANIZUAR NGA "UDHA E SHKRONJAVE"
në bashkëpunim me Familjen e Pashko Vasës (30 gusht 2026)

